

1 E mërkurë, 22 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi dhe mirë se keni ardhur.

7 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Shoh që ZPS-ja ka të njëjtën përbërje sikurse dhe dje.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Shohim që e njëjta gjë vlen për Mbrojtësin e Viktimave.

17 Dhe në të majtë, Avokat, keni ndonjë ndryshim?

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi i njëjti ekip vetëm znj.

19 Kailin Chen, do na bashkëngjitet pak më vonë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi

21 dhe z. Shala këtu me. Mirëmëngjes, z. Shala. A konfirmoni që
22 më dëgjoni?

23 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë

24 mirë. Mirëmëngjes.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë. Pra, videolidhja punon në rregull.

2 Do të diskutojmë diçka në seancë private fillimisht.

3 Sidoqoftë, kam nevojë të them diçka për qëllime sqarimi.

4 Dje, përdora fjalën "acarim" ose "zemërim". Unë, në fakt,

5 desha të thoja "irritim". Më ngatërroj pak fakti që di

6 italisht edhe përdora fjalën gabimisht, po thjesht dua që të

7 jetë e qartë për procesverbal.

8 Sekretare e Gjykatës, ju lutem të kalojmë në seancë

9 private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Prokuror, fjala është për ju.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

19 Përpara se të vazhdojmë me pyetjet me këtë dëshmitar, do
20 të doja të merrja lejen e Trupit Gjykes që të shtoja në
21 listën e materialeve një video, që është videoja e intervistës
22 që ka pasur dëshmitari me ZPS-në, Pjesa 2, do t'ju jap dhe
23 numrin e referencës për një çast.

24 Arsyeya për këtë vonesë është se ne e diskutuam dy
25 aspekte dje. Për ndërtesën me ngjyrë të bardhë, që pati një

1 debat goxha të gjerë me Mbrojtjen dhe mes nesh dhe Mbrojtjes,
2 në lidhje me këtë ndërtesë dhe në moment doli kërkesa nga ana
3 e Mbrojtjes që t'i tregonim videon. Kështu që me kënaqësi duam
4 t'jua tregojmë videon dhe të dëgjojmë komentet e tij.

5 Një pikë tjetër kontestuese dje ishte lidhur me kamionët
6 në uzinën mekanike të Kukësit edhe për këtë duam të tregojmë
7 një video dhe t'i kërkojmë dëshmitarit të japë komentet e
8 veta. Për mendimin tonë, këto janë shumë të rëndësishme dhe do
9 donim që t'i fillonim pyetjet tona me këto dy video.

10 Prandaj unë po kërkoj që ju të merrni një vendim në
11 lidhje me këtë. Kjo nuk e cenon aspak Mbrojtjen, sepse këto
12 materiale janë nxjerrë në bazë të rregullës 181, në nëntor të
13 këtij viti. Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Avokat, fjala është për ju.

17 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

18 Sikurse e kemi thënë dhe më herët, këtu jemi të zbulojmë
19 të vërtetën. Më duket krejt e drejtë. Nuk kemi asnjë koment në
20 lidhje me këtë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Mbrojtësi i Viktimave, keni diçka për të thënë?

24 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, ju faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi

1 Gjykues, atëherë e lejon që të shtohen këto dy materiale në
2 listën e prezantimeve. Kërkesa juaj miratohet.

3 Prokuror, mund të filloni sapo që të sjellim dëshmitarin
4 në sallë.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbal, mund t'ju jap
6 dhe numrat e referencave për këtë video 077875B, Pjesa 2, RED.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 marrim parasysht, faleminderit.

9 Asistente, sillni dëshmitarin në sallë.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
12 se erdhët, Dëshmitar.

13 DËSHMITARI: Mirë se ju gjej.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Dëgjoni? Besoj më dëgjoni mirë?

16 DËSHMITARI: Po, shumë mirë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Shala, ju e dëgjoni dëshmitarin?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. E ndëgjoj
20 shumë mirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Dëshmitar, si jeni sot?

24 DËSHMITARI: Mirë, mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 10

1 Dëshmitar, ju kujtoj që jeni ende nën betim për të thënë të
2 vërtetën. E kuptoni këtë?

3 DËSHMITARI: Po, në rregull.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
5 vazhdojmë me kundërpjetjet nga Zyra e Prokurorit të
6 Specializuar. Dhe tani do t'ia jap fjalën Prokurorit.

7 DËSHMITARI: W03887 [Vijon]

8 Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk:

9 [Vazhdon]

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

11 PY. Mirëmëngjes, z. Hoxha.

12 PY. Mirëmëngjes.

13 PY. Si u gdhitë?

14 PË. Mirë. Ju, si jeni kanë?

15 PY. Z. Hoxha, dje diskutuam atë çështjen e atyre kamionëve të
16 prishur që ishin të parkuara në një vend të caktuar në uzinën
17 mekanike të Kukësit. Në faqen 93, rreshtat 5 dhe 8 të
18 transkriptit të ditës së djeshme, ju na thatë se ishin tri a
19 katër të prishur të vendosur diku në mes të ndërtesës, të
20 kompleksit të ndërtesave dhe bllokunin pamjen e asaj ndërtesës
21 me ngjyrë të bardhë. Ju thatë kështu:

22 "Atje ku është numri 3, kishte tri a katër kamionë,
23 kamionë të prishur që ishin parkuar atje. Unë nuk jam i sigurt
24 a ishin tri a katër. Po ajo pjesë e oborrit nuk mund të
25 shihej. Një person, domethënë, e kishte të pamundur të shihte

1 se çfarë kishte atje”.

2 E keni përsëritur sërish këtë punën a tri a katër
3 kamionëve dhe thatë që ju nuk mund ta shihnit atë pjesë të
4 oborrit, kjo është e reflektuar në faqen 96, rreshtat 3 deri
5 në 8, ose e thatë ndryshe që kjo pjesë nuk ka qenë e dukshme.
6 Edhe kjo është reflektuar në faqen 104 rreshtat 24 dhe 25 të
7 transkriptit të ditës së djeshme. Fillimisht të sqarojmë
8 njëherë sa kamionë ka pasur atje, kamionë të prishur.

9 Dje thatë tri a katër. Nuk ishit i sigurt. Sidoqoftë, unë
10 dua t’ju tregoj çfarë keni thënë në intervistën me ZPS-në.
11 Edhe do të shohim fillimisht dokumentin, më pas videon.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është dokumenti 0778857-TR-ET,
13 Pjesa 2, faqja 5, rreshtat 19 deri në 22.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Vazhdoni, Sekretare.

16 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Duke qenë se ky
17 është një aspekt i rëndësishëm, do donim që të shihnim edhe
18 versionin në shqip të transkriptit që të eliminojmë çdo
19 mundësi keqkuptimi.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
21 kemi dhe referencat për shqipen.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk i kam po duhet të jetë në
23 të njëjtën faqe, në të njëjtën faqe duhet të jetë edhe në
24 transkriptin në shqip.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull.

2 Sekretare, ju lutem vendosni dhe versionin në shqip
3 përbri.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Versioni anglisht janë rreshtat
5 19 deri në 22.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 21, shoh një fjalën "... kamion". Po s'jam e sigurt a i përkon
8 anglishtes.

9 Faleminderit. Ky është informacioni që mora dhe unë nga
10 kolegu.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të vazhdoj?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
13 po. Po shihja diçka. Njësia e përkthimit na tha që është nga
14 rreshti 13 e poshtë.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

16 PY. Z. Hoxha, në atë pjesë që unë do ju lexoj, ju thoni
17 kështu, si në vijim:

18 "Për shembull, jashtë ndërtese, ndërtesën në vendet e
19 ndërtesës, tek kjo uzina këtu, ka qenë një kamion i prish. Ka
20 qenë kamion që aty kam flejtë".

21 Në Pjesën 2 të deklaratës tuaj dhe unë e kam rishikuar të
22 gjithën dje, ju keni përmendur vetëm një kamion. Keni thënë që
23 vetëm një kamion ka qenë në ndërtesën e uzinës mekanike dhe ky
24 është dhe kamioni që keni fjetur. Dhe e përmendët dhe ju dje,
25 ai kamioni që flinit ju, kishit fjetur ju.

1 Po nëse ka pasur tri a katër kamion, siç thatë dje, në
2 oborrin e uzinës mekanike, ju pse në vitin 2020 i keni thënë
3 Prokurorisë që ka qenë vetëm një, një kamion i prishë?
4 PË. Unë sa e di dhe atëherë kam deklarua që kanë qenë tre apo
5 katër kamiona të prishur. Unë një e kam deklaruar që kam fletë,
6 në një pi këtyne. Po kanë qenë apo katër nuk jam i sigurtë.

7 PY. Z. Hoxha, ju thatë që kishte kamion që hynin e dilnin nga
8 uzina mekanike. Por, ama për kamion të prishur, në intervistën
9 që i keni dhënë Prokurorisë - në të gjithë intervistën - keni
10 përmendur vetëm një kamion të prishur. Çfarë mund të na thoni
11 në lidhje me këtë? A ka pasur një kamion, siç i keni thënë
12 Prokurorisë në 2020, apo tri a katër kamionë sikurse thatë
13 dje?

14 PË. Jo, aty kanë qenë tre ose katër kamiona kanë qenë të
15 prishur.

16 PY. Shumë mirë. Kam nevojë të sqarojë pak edhe vendin e saktë
17 ku ka qenë ky kamion apo këta kamion të prishur në uzinën
18 mekanike të Kukësit. Në dëshminë që dhatë dje, ju thatë që
19 kamioni apo kamionët ishin diku në mes të kompleksit të
20 ndërtesave dhe bllokunin atë ndërtesën e bardhë që ne
21 diskutuam dje?

22 PË. Po, ashtu është.

23 PY. Për shembull, në faqen 107, rreshtat 21 dhe 22 të
24 transkriptit të djeshëm, ju thatë si në vijim:

25 "E di që se nxirrja tavolinën jashtë dhe punoja aty ku

1 ish in ata kamionët. Fiks aty ku është numri 3. Aty nxirrja
2 tavolinën time dhe punoja".

3 Por unë dua t'ju tregoj një pjesë, më saktë një video të
4 intervistës suaj me ZPS-në.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe për procesverbal, kjo është
6 videoja me numër 08577B, Pjesa 2, RED. Me lejen tuaj, do të
7 doja që kjo video të shfaqet në ekran.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Propozimi im, është që në të
11 djathtë të videos të nxjerrim dhe transkriptin në anglisht, që
12 është me numër 00857-TR-ET, Pjesa 2, faqja 5.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Vazhdoni.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 5. Dhe shohim rreshtat
16 nga 16 deri në 25.

17 Desha, Sekretare, të shohim videon nga minuta nga 10:28
18 deri në minutën e 12.

19 [Luhet vidioincizimi]

20 "Përkthyesi: [Zëri] "PY. A mund të na e tregosh në këtë
21 fotografi panoramike, ku në çfarë vendi keni flejtë, kur keni
22 flejtë, për shembull, jashtë ndërtesës apo në ndërtesë po në
23 vend tjetër të ndërtesës?

24 "PË. Tek kjo uzina këtu ka qenë një kamion i prishë ka
25 qenë. Kamion, qaty kam flejtë.

1 "Përkthyesi: [Zëri] PY. A është vendi i saktë ky ku kam
2 vënë gishtin unë?

3 "PË. Po.

4 "Z. Elderkin: Z. Hoxha tha po, ky ishte vendi ku që unë
5 tregova që ku ishte kamioni i prishur".

6 A mund të kthehemi tek minuta 11:45 dhe ta ndaloni
7 incizimin aty? E njëjta video, po vetëm ndaloni tek ajo minutë
8 që ju tregova në atë segment, 11:45.

9 PY. Nga kjo video që sapo pamë, ju vetë, z. Hoxha, i keni
10 thënë Prokurorit se ku ishte parkuar apo ku gjendej ky kamion
11 i prishur. Dhe, siç e shifni në këtë imazh këtu, në këtë
12 fotografi, nuk ka qenë në mes të oborrit po afër murit të
13 depos ku ke punu ti. A e konfirmon këtë?

14 PË. Z. Prokuror, vetëm një po harroni se kjo faktikisht këtë
15 intervistë e kam dhënë 20 vjet mbas lufte. E dyta, nuk kam
16 qenë i përgatitur për me dhënë intervistë se nuk i kam mendu
17 këto sende që kam me nevojit kurrë në jetën time. Dhe
18 faktikisht kur e kam dhënë këtë intervistë mundet me ndodhë që
19 kam gabue. Tash e dy vjet që më keni marrë në pyetje
20 faktikisht kam pasë kohë me u mendue komplet skenën faktikisht
21 qysh ka qenë, tek qenë, sa mu ka kujtue.

22 Kur më keni marrë së pari herë në pyetje atëherë kam qenë
23 edhe i pa përgatitun. Mundet me ndodhë që kam thënë vetëm një
24 kamion, po unë po them që kanë qenë tre ose katër.

25 PY. Tani për tani, nuk po flasim për numrin e kamionëve, po

1 flasim për vendin ku ka qenë i vendosun ky kamioni i prishun.
2 Dhe siç e tregova tani, Prokurori ju ka vendos gishtin aty ku
3 ka qenë parkuar ky kamioni i prishun dhe ju ka pyet "A është
4 ky vendi ku e keni fjalën?" dhe ju i jeni përgjigj "Po". Dhe
5 në përballë jush ai e ka vu gishtin aty ku ka qenë muri i
6 depos, nuk është mes të oborrit gishti i tregum, apo jo?
7 PË. Po faktikisht është shenjë paralele është. Nuk është
8 bash, s'do me thënun që ka qenë i parkum bash në muri. Është
9 që ajo paralele faktikisht qa ai drejtim është që kanë qenë
10 kamionat e parkum. Përndryshe me i kshiqu incizimet komplet
11 pandërpemje ki edhe nëpër pjesë tjetër që ka edhe kamiona të
12 tjerë të prishë. Po këtu kanë qenë tre ose katër. Se ata
13 kamionat pa ndërpre kanë bartë material ushtarak dhe ushqimor.
14 Ka pasur edhe tjerë kamiona. Nuk ka pasur vetëm aty të parkum
15 të prishtë, po ka pasë edhe në pjesë të tjera mbrena uzinës,
16 mbrena oborrit të uzinës.

17 Me këqyrë incizimin komplet, me këqyrë faktikisht, i shef
18 edhe tjerë kamion a muj me tregu saktësisht se cilët kanë qenë
19 me defekte.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Avokat Mbrojtës, keni fjalën ju.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Kemi një kundërshtim
23 për të cilin besoj që duhet të largohet dëshmitari nga salla
24 sepse është një çështje procedurale.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

1 vazhdojmë kështu atëherë.

2 Z. Dëshmitar, do t'ju shikojmë jashtë për pak çaste.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Fjalën e keni ju, Avokat Mbrojtës.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

7 Kërkoj ndjesë për ndërprerjen.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
9 keni nevojë të kërkonit ndjesë për ndërprerjen, për këto lloj
10 ndërhyrjeje.

11 Z. AOUBINI: [Përkthim] Dje e kemi theksuar dhe kjo është
12 pjesë që e ka përmendur kolegu im dëshmitarit, duam të
13 ritheksojmë këtë pjesë në faqen 23, rreshtat 15, 19, kur ky
14 dëshmitar flet dhe thotë:

15 "... ka pasur edhe aty kamion të parkuar".

16 Po, pra, përpara se të shkojmë tek diskutimi ka qenë një
17 kamion apo disa, kjo pjesë duhet të qartësohet paraprakisht,
18 ku dëshmitari thotë të pasur të parkuar pjesa e tyre të
19 prishur kanë qenë të parkuar aty. Kjo është pika e parë, që do
20 të ishte e drejtë për qartësim.

21 Dhe, së dyti, siç mund ta shohim tani dhe përpara se të
22 shkojmë më tej, fotografia që tregohet është një panoramë
23 fotografish, pra, janë shumë fotografi së bashku. Kjo është
24 pikë që duhet të theksohet, sepse ka qenë problem dhe me një
25 pjesë tjetër të kompleksit.

1 Këto janë dy pikat që duam të trajtohen sepse në qoftë se
2 ballafaqojmë dëshmitarin, duhet të japim një pasqyrë të plotë
3 të gjendjes sa i përket dokumenteve që përdoren dhe ato që ai
4 ka thënë në deklaratat e tij të mëparshme.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
6 mund ta sqaroni pak këtë pjesën e panoramës se s'e mora vesh.

7 Z. AOUIINI: [Përkthim] Në shumë vende në intervistë i
8 referohet, përdoren foto dhe panorama.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Konkretisht për këtë fotografi. Unë shoh një fotografi këtu,
11 shoh një gisht, një gisht që tregon në një vend të caktuar, i
12 drejtuar drejt një vendi në fotografi. Cili është pika që ju
13 po ngrini mbi neve sa i përket panoramës. Ne nuk po shohim
14 panoramën në tërësi, po shohim këtë pikë në veçanti.

15 Z. AOUIINI: [Përkthim] Tani që dëshmitari nuk është këtu,
16 ishte problemi dhe me pjesën tjetër ku dëshmitari ka thënë që
17 nuk e ka parë, s'e ka parë kurrë atë fotografi, atë ndërtesës
18 së bardhë siç ka qenë.

19 Dhe ai tha dhe ai ka thënë që ka qenë një panoramë që ju
20 më keni treguar. Këtu kemi mundësinë që, copëza, pra, të
21 vendosura së bashku që i tregohen dëshmitarit. Kur dëshmitari
22 flet për panoramë për këtë e ka fjalën. Nga ajo që kuptoj unë
23 nga transkripti i intervistës është edhe që dëshmitarit i janë
24 treguar fotografi të vendosura së bashku në formë panorame
25 pra.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
2 që e sqaruat këtë. Lidhur me këtë pikë konkretisht, nuk po
3 shoh ku është problemi.

4 Prokurori do të ketë mundësi që të shprehet lidhur me
5 këtë pikë dhe pastaj do them ato që kam për të thënë.

6 Z. Prokuror.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ca vërejtje të shkurtra. Së
8 pari nuk po flasim për kamionë, por flas për kamionë të
9 prishur vetëm, jo ata që vinin, hynin e dilnin. Po flas për
10 kamion që dëshmitari ka përmendur disa herë dje. Vetë foli për
11 dy-tre kamionë të prishur. Dhe unë po përqendrohem vetëm tek
12 kjo pjesë.

13 Pak më parë sot vërtetova që ai në intervistën e ZPS-së
14 ka përmendur vetëm një kamion të prishur, jo disa. Pastaj më
15 vonë, në goftë se lexoni transkriptin apo bashkëvijimin e
16 intervistën me ZPS-në, nuk la dyshim që Prokurori e ka
17 diskutuar në mënyrë metodike çështje e kamionëve të prishur.

18 Dhe menjëherë pas dëshmitarit i kërkohet që të tregojë
19 saktësisht ku ishte ky kamion i prishur. Dhe ai tregon pjesën
20 afër murit. Pra, nuk besoj që ka ndonjë dyshim sa i takon
21 vendit të cilin e ka treguar dëshmitari në intervistën e tij
22 me ZPS-në. Nuk e besoj që e kemi prezantuar, pra, këtë mënyrë
23 që mund të ishte e padrejtë dhe për dëshmitarin.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Mbrojtësi i Viktimave, a ka diçka për të thënë?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Atëhere, lidhur me këtë, cila është kërkesa juaj, z. Avokat
5 Mbrojtës, sa i takon pjesës që po i paraqitet dëshmitarit? A
6 dëshironi që t'i tregoni ndonjë pjesë tjetër dëshmitarit që të
7 jemi të drejtë me të?

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Është, bëhet fjalë për numra dhe jo
9 vendi. Pajtohem me këtë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur
11 t'ju vijë mundësia që të bëni pyetje përsëri, do keni
12 mundësinë që të bëni këto pyetje dhe ta qartësoni këtë pjesë.
13 Për pyetjet, sipas mendimit tim, që janë paraqit deri tani
14 janë të gjitha relevante. Nuk shoh sesi mund të jenë
15 çorientuese. Pjesa që ju tregua dëshmitarit dhe ka dhe një
16 pjesë tjetër, është shumë e qartë që ka të bëjë me kamionët e
17 prishur. Dhe pyetja që do të kisha bë edhe unë, në qoftë se
18 Prokurori nuk do ta kishte bë këtë pyetje pra.

19 Nuk do shkojmë, nuk do debatojmë këtë pikë. Nuk do
20 diskutojmë më për këtë çështje.

21 Avokat Mbrojtës, nuk jua dhashë fjalën. Dhe nuk mund të
22 ngriheni në këmbë dhe të flisni ndërsa që s'ju kam dhënë
23 fjalën. Tani po jap vendimin tim.

24 Kundërshtimi rrëzohet dhe kur t'ju vijë radha për të bërë
25 pyetje përsëri, do të mund të merrni fjalën, por mos flisni në

1 të njëjtën kohë se unë nuk do ta lejojë një gjë të tillë.

2 Znj. Sekretare, sillnin dëshmitarin në sallë përsëri, ju
3 lutem.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Prokuror, e keni fjalën ju.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

8 PY. Z. Hoxha, si keni udhëtuar nga Gjermania në Kukës? E kam
9 fjalën me çfarë mjeti transporti?

10 PË. Kam udhëtu me një xhip.

11 PY. A e parkuat këtë makinë në ambientet e uzinës mekanike
12 aty në Kukës kur keni mbërrit?

13 PË. Jo, atë xhip në faktikisht e kemi pasë një ndeshje në
14 Itali, e kemi patë një ndeshje, pej Italie me trajekt e kemi
15 pru në Shqipëri dhe në Tiranë e kemi lënë atë xhip. Në Kukës
16 kemi shku me një Ford Escort kemi shku. Ka qenë makina e një
17 shokit.

18 PY. Tani që po flasim për këtë makinë të shokut, a e parkut
19 këtë makinë në uzinën mekanike në Kukës?

20 PË. Po mbrena oborrit ka qenë.

21 PY. Në cilin vend?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
23 që z. Shala, ngriti dorën. Dua të shoh se çfarë ka për të
24 thënë z. Shala.

25 Z. Shala, për çfarë dëshironi të flisni?

1 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit. Kam
2 nevojë vetëm një sqarim të shkurt me Avokatin. Në qoftë se
3 është mundësia një pauzë të shkurt. Vetëm një pyetje e bën
4 Avokati, veç për konsultim.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, z. Shala. Tani në orën 11.00 kemi pushimin e
7 drekës do t'ju jepet mundësia të konsultoheni me Avokatin.

8 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuar Gjyqtare,
9 bëhet fjalë vetëm për lëndën se është e propozime tani për
10 momentin që është në vizatim. Për atë deshta vetëm një pyetje
11 t'ia bëjë Avokatit dhe Avokati e bën.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
13 kuptoj këtë që po thoni, z. Shala, por tani nuk është momenti
14 i duhur për të ndërprerë procesin, që ju të konsultoheni me
15 Avokatin. Ne do vazhdojmë me pyetjet e Prokurorit dhe Avokatët
16 tuaj do të konsultohen me juve dhe në qoftë se është diçka për
17 t'u qartësuar, do të bëhet më vonë. Faleminderit.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 PY. Z. Hoxha, në atë makinën që udhëtuat me shokun tuaj nga
20 Tirana në Kukës, ku është parkuar në uzinën mekanike?

21 PË. Mbrena oborrit, mbrena oborrit të uzinës ka qenë e
22 parkume. Të dyert kryesore ku ka qenë faktikisht hymja e
23 depos, në anën e majtë ka qenë e parkume.

24 PY. A u parkua te muri i depos apo me ndonjë vend tjetër?

25 PË. Afër murit faktikisht.

1 PY. Tani do t'ju lexoj një pjesë shumë të shkurtër të
2 deklaratës tuaj që i keni dhënë ZPS-së, që ka të bëjë me
3 vendin saktësisht ku është parkuar kjo makinë.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Referenca e kësaj është 077857-
5 TR-ET, Pjesa 2, faqja 7, rreshtat 19, 22.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
7 Sekretare, shfaqnin dokumentin në ekran ju lutem.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqe 7, rreshtat 19, 22 të
9 transkriptit në gjuhën angleze.

10 PY. Prokuroria ju ka bërë të njëjtën pyetje lidhur me venin
11 se ku ishte vendosur, parkuar makina.

12 "PY. Ku ishte e parkuar makina juaj personale gjatë
13 kohës që keni qenë në Kukës?

14 Përgjigja juaj ishte:

15 "Ka qenë e parkuar aty afër kamionit që e përmenda më
16 herët. Ka qenë e parkume aty vazhdimisht".

17 Për informacionin tonë, kamioni për të cilin po flisni
18 është i njëjti kamion i prishun për të cilin folëm më herët.

19 Pra, nga kjo pjesë e intervistës me ZPS-në, rezulton ose
20 duket që makina juaj ka qenë e parkuar afër kamionit të
21 prishur. Dhe sot, pak më herët, thatë që makina ime thatë që
22 ka qenë e parkume afër murit të depos. A është kështu?

23 PË. Më fal, z. Prokuror, po makina jonë ka lëvizë. Nuk ka
24 qenë në të njëjtin vend gjithmonë, nuk ka qenë ajo e parkume
25 në të njëjtin vend. Ka lëvizë faktikisht. Edhe njëherë dhe ka

1 pasë dhe një defekt, një shok që e ka vozit e ka thy edhe
2 karterin poshtë.

3 Ka lëvizë ajo makinë, herë është parku në një vend, herë
4 në një vend, herë një vend. Nuk ka ndejt pandërprerje në të
5 njëjtin vend. Ajo makinë ka lëvizë. Ajo ka qenë në gjendje të
6 rregullt. Kur kanë pasë nevojë shokët faktikisht e kanë marrë
7 makinën, janë shku, kanë kry punë edhe ku ka pasë vend e kanë
8 parkue. Po zakonisht, zakonisht në qatë pjesë është parkue.
9 Unë s'muj me thanë tash 100 për qind që gjithmonë ka qenë në
10 të njëjtin vend. Po ka ndryshu vendet se makina ka lëvizë, aty
11 parkingje të rezervume nuk kemi pasë na për makinat tona, ku
12 ka pasë vend aty e kemi parkue.

13 PY. Z. Hoxha, tani do ju them këtë. Të flasim logjikisht, për
14 çfarë arsye mund të thotë dikush, do të kishte vendos disa
15 kamiona të prishun mes të oborrit duke pengu edhe qarkullimin,
16 lëvizjen e lirë të makinave që hyjnë e dalin, pse mos me i vu
17 anash diku në një vend? Cila është përgjigja juaj?

18 PË. Ajo nuk ka qenë detyrë e imja me i tregu se ku me i parku
19 kamionat e prishtë. Aty ka qenë detyrë e tjetërkujna. S'ka
20 qenë detyra ime. Unë e kam pasë detyrën time, e kam kry me
21 nder e kam kry atë detyrë. Edhe nuk kam pasë kohë me u marrë
22 me tjerat sende. Qysh po mendoni kohë pas kohe faktikisht unë
23 s'kam pasë kohë as me u marrë me vetveten ndoshta e lë mo me u
24 marrë me sendet e imta dhe me incizue.

25 Ka qenë kohë lufte. Ju njat po e harroni. 450 masakra

1 kanë ndodhë në Kosovë. I kanë vra fëmijën pej tre muajve deri
2 në 90 vjeç. Ku anë ata kriminelë? Ata duhet me i lypë. Tash po
3 merrhu për një makinë po më merrem në pyetje si me kanë
4 kriminel. S'po ju kuptoj.

5 PY. Z. Hoxha, nuk po them që ju jeni kriminel. Thjesht po
6 përpiqem të marrë nga ju atë që ju keni, ajo që ka ndodhë me
7 të vërtetë. Ajo që keni pa, që e keni përjetu aty në lokalet e
8 uzinës në Kukës, në ambientet aty. Po përpiqem të jem sa më i
9 detajum, i hollësishëm sa është e mundur. Thjesht po kërkoj të
10 vërtetën në atë që keni përjetu, që keni pa, që keni qenë.

11 PË. Z. Prokuror, ndodh që edhe mbrëmë çka kena hëngër darkë
12 kemi harrue, lë më 25 vite me i mbajt ndërmend imtësinat. Ato
13 kanë qenë imtësina faktikisht. Na nuk i kemi dit si popull ku
14 i kem kryet, as këmbët.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do të doja të ndryshoj, të
18 kaloj në një temë tjetër.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
20 Sepse ka kohë tashmë që po merremi me këtë temë.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Përfundova me këtë. Dua të
22 kthehem tek kjo pika e djeshme e ndërtesës së bardhë që ishte
23 pikë që kundërshtohet nga palët.

24 PY. Z. Hoxha, dje, në faqen 94, rreshtat 17, 23, faqen 103,
25 rreshtat 13, 14 dhe faqen 105, rreshtat 5 dhe 10, na thatë se

1 fotografia ku paraqitej ndërtesa e bardhë, që për të cilën
2 biseduam dje dhe që ju shënuat me numër 5 me fotografi nga
3 ajri, kjo fotografi nuk ju ishte treguar gjatë intervistës me
4 ZPS-në në 2020. Ju biles thatë që ju s'e kishit parë kurrë
5 këtë fotografi në jetën tuaj asnjëherë e thatë, kjo gjendet në
6 faqen 103, rreshtat 13, 14, rreshtat 20, 21, faqen 112,
7 rreshtat 2021. A është kështu?

8 PË. Po. S'e kam pa atë fotografi asnjëherë nuk e kam pa.
9 Është edhe një fotografi mbrapa faktikisht është një dhomë një
10 pulë është mbrena. S'e kam pa në jetë time, s'e kam pa atë
11 fotografi kurrë. As Prokuroria s'ma ka tregu. As e kam pa
12 kurrë.

13 PY. Shumë mirë. Lidhur me këtë do t'ju tregoj tani një video
14 të shkurtër, këtë pjesë të videos së intervistës me ZPS-në në
15 2020.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Numri i kësaj videoje është
17 077857B, Pjesa 2, RED.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
19 Sekretare, shfaqni videon e kërkuar ju lutem.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të nxjerrim në ekran, të
21 shfaqim në ekran edhe transkriptin përkatës të intervistës në
22 anglisht. Me numër 077857-TR-ET Pjesa 2, faqe 22.

23 Nga rreshti 1 deri në rreshtin 12. Kështu siç është.

24 Në qoftë se mund të lëshojmë videon nga minuti i 50:15 në
25 minutën 51:34.

1 [Luhet videoincizimi]

2 "Përkthyesi: Do t'ia tregoj edhe kamerës këtë. Pra, nën
3 vinçin metalik. Dhe me sa kuptoj unë në atë kohë që nuk është
4 fotografinë panoramike ka qenë një ndërtesë e vogël që është
5 tani është shkatërruar. Është një foto me numër 074390. Kjo
6 është një ndërtesë që ekzistonte më përpara në atë vendin ku
7 unë tregova me gisht në fotografinë panoramike"

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

9 PY. Z. Hoxha, kjo ishte intervista juaj me ZPS-në. Dhe kjo
10 është ndërtesa për të cilën biseduam dhe gjerësisht. Është
11 akoma qëndrimi juaj që gjatë intervistës me ZPS-në kjo
12 ndërtesë nuk ju është treguar gjatë intervistës suaj me ZPS-në
13 dhe që s'e keni parë kurrë këtë fotografi më parë.

14 PË. Mu s'më kujtohet që e kam pa këtë fotografi. Faktikisht,
15 fotografitë e uzinës kur m'i kanë tregu, tregova dhe dhe, ka
16 qenë ka gjatësia. Kanë qenë dy pjesë të ndërtesave faktikisht.
17 Po në mes, ku po thoni ju që ka qenë kjo ndërtesë, ka qenë
18 vetëm si maket, ka qenë e kapmë me selotep në mes, këtë
19 ndërtesë unë s'e kam pa asnjëherë.

20 PY. Z. Dëshmitar, desha të bëj një përmbledhje të asaj që
21 kemi dëgjuar nga ju për këtë ndërtesë dhe dhe sot. Pra, keni
22 punuar në depo, që ka qenë në të njëjtin oborr siç është edhe
23 kjo ndërtesa e bardhë. Deklaruat në raste të caktuara keni
24 punu edhe jashtë depos në oborr. Ka ndodhë edhe që keni fjet
25 në oborr, keni ec, kalu nëpër oborr për me shku në depo, te

1 fjetorja, te kuzhina, te pjesa mjekësore dhe mesa duket keni
2 marrë pjesë ndonjëherë edhe në ushtrime fizike në oborr dhe
3 mesa duket kamioni i prishur nuk ka qenë në mes të oborrit, po
4 aty ku ka qenë depoja dhe nuk të ka pengu pamjen tënde për me
5 ndërtesën që ka qenë mbrapa.

6 A vazhdoni të mbani qëndrimin që ju nuk ju kujtohet këtë
7 ndërtesë, pra, ndërtesën e bardhë, që ka qenë bukur e madhe
8 dhe që ka qenë pothuajse në mes të oborrit, prapë është
9 qëndrimi juaj që nuk e keni pa këtë?

10 PË. Prapë a qëndrimi jem që nuk e kam pa. S'kam pasë kohë unë
11 me u marrë me tjera ndërtesa apo me tjera objekte ku janë tek
12 janë. Unë e kam pasë detyrën time faktikisht pej dhomës së
13 fjetjes, pej Shtabit të Përgjithshëm unë në depo.

14 PY. Z. Hoxha, kemi dëgjuar dëshmi të dëshmitarëve të tjerë në
15 këtë rast, në këtë lëndë, që thonë që në kohën kur keni punu
16 në uzinën mekanike në Kukës, kjo ndërtesë që po flasim është
17 përdorë për të mbajtur persona të ndaluar aty. Dhe mbajtja nën
18 ndalim e personave në uzinën mekanike në Kukës është vërtetuar
19 në gjykimet kundër Sabit Gecit dhe Xhemshit Krasniqit të cilët
20 janë dënuar për mbajtje në ndalim dhe keqtrajtimin e personave
21 në atë vend.

22 A ke pasë dijeni ti, ke qenë në dijeni që gjatë kohës që
23 ke qenë në uzinën mekanike në Kukës që në atë ndërtesë ka pasë
24 njerëz që janë mbajtur në ndalim?

25 PË. Jo, s'kam qenë në dijeni.

1 PY. Më vonë a ke marrë vesh, a ke mësu këtë informacion pas
2 shpalljes fajtor të Xhemshit Krasnqit dhe Sabit Gecit që a e
3 ke marrë vesh pastaj më vonë që ka ndodhë kjo gjë?

4 PË. Po, kam marrë vesh shumë ma vonë.

5 PY. Kur e ke marrë vesh këtë?

6 PË. A nuk di. Nuk po më kujtohet. Nuk e di në cilin vit ka
7 qenë.

8 PY. Tani dua që të pyes shkurtimisht lidhur me disa prej
9 vendeve ku keni fjet në uzinën mekanike në Kukës. Për momentin
10 keni vërtetu që keni fjetur në depo për një kohë të caktuar
11 aty ku keni punu, kjo është në faqen 82, rreshtat 21, 24,
12 pastaj në faqen 84, rreshti 14. A është kështu?

13 PË. Jo, nuk kam flejtë për një kohë. Faktikisht, më ka ndodhë
14 një natë apo dy nuk jam i sigurt, jo një kohë të gjatë po
15 mendoj. Kam flejtë një natë apo dy, nuk e di. Nuk jam i
16 sigurt.

17 PY. Po. Po ashtu keni thënë se në një rast keni fjetur tek ai
18 kamioni i prishur. Kjo është e reflektuar në faqen 114,
19 rreshti 20 dhe 21 të transkriptit të djeshëm. Kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Po ashtu përmendët një dhomë që ka qenë zyra e Latif
22 Fejzullahut me tre krevat dhe kjo është e reflektuar në faqen
23 6, rreshti 1 dhe 2 dhe 7 të transkriptit të djeshëm. Kështu?

24 PË. Po, 95 për qind të rasteve kam flejtë aty.

25 PY. A keni fjetur dhe në vende të tjera veç këtyre që sapo

1 përmenda?

2 PË. Jo, s'kam pasë raste tjera.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja
4 që shpejt e shpejt të vendosnim në ekran një intervistë të
5 ZPS-së 077875-TR-ET Pjesa 1, faqja 18.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Patjetër.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 18, rreshtat 15 deri në
9 24.

10 PY. Z. Hoxha, ju ka pyetur Prokurori:

11 "Ku flinit?"

12 Ju i jeni përgjigjur:

13 "Flija gjithandej, për të thënë të vërtetën kudo flija,
14 nuk kisha një shtrat që të shkoja tek shtrati im. Ku gjeja një
15 vend për të fjetur, flija. Dhe shpesh, asnjëherë në të njëjtin
16 vend, sepse ishte dhe një proces në lëvizje atje. Kishte
17 persona, kishte ushtarë që vinin nga Tirana për të shkuar në
18 Kosovë, kështu që ndonjëherë nuk kisha as shtrat për me fjet.
19 Flija në kamion apo kudo që të gjegja vend. Kështu. Kështu
20 ndodhte".

21 Nga ky fragment i shkurtër që unë ju lexova që ju keni
22 pasur me Prokurori, duket sikur ju keni fjetur në shumë vende,
23 ku të gjenit një vend, a është e saktë kjo?

24 PË. Po unë e ceka faktikisht, që më ka ra rasti kam flejtun
25 në depo, më ka ra rasti kam flejt në kamion. Më ka ra rasti

1 faktikisht shtrat që me thënë shtrat temin nuk kam pasë.

2 E tregova dhe dje, zyrën e Latif Fejzullahit ku kemi
3 flejtë faktikisht ka qenë përfuni shtratit ka qenë një
4 sfungjer, aty herë kam flejtë unë, herë ka flejtë Bedri Azemi.
5 Kur kam shku unë përpara e kam hjek sfungjlerin, kam flejtë në
6 sfungjerë ja kam lëshu vendin, shtratin atijna. Por kur ka
7 shku ai para meje me shku me flejtë ai e ka nxjerrë
8 sfungjlerin, mu ma ka lënë shtratin e lirë. Kështu që shtrat të
9 caktum ku me flejtë nuk kam pasë. Se ka pasë qarkullim shumë
10 të ushtarëve faktikisht dhe nuk kemi pasë as vend sa duhet.

11 PY. Kuptoj. Flasim për uzinën mekanike të Kukësit dhe
12 veprimtaritë atje, kishte shumë lëvizje gjatë kohës që ishit
13 ju atje?

14 PË. Po ajo ka qenë faktikisht logjistika kryesore, ka qenë
15 për frontin e operacionit Shigjeta. Të gjitha Brigadat që kanë
16 hy mbrena në Kosovë në atë pjesën ka ana Cahanit e Krumës,
17 faktikisht kanë ardhë ka kazerma jonë aty. Janë furnizu me
18 ushqime, janë furnizu me armatime, janë furnizu me uniforma,
19 me të gjitha. Ka pasë qarkullim pandërpreje, ka pasë qarkullim
20 asajde. Ka ndodhë edhe natën, le më ditën po edhe natën ka
21 ndodhun.

22 PY. Ka qenë i zhurmshëm si vend?

23 PË. Jo, që me thënë i zhurmshëm faktikisht, normal kur ka
24 qarkullim të njerëzve shumë, normal që bëhet edhe zhurmë, ajo
25 dihet. Po secili e ka pasë detyrën e vet. Secili e ka pasë

1 punën e vet.

2 PY. Po ju sapo na thatë që ishte vendi kryesor ku hynin e
3 dilnin personat, ku hynin e dilnin kamionë. E kuptojmë që ka
4 qenë qendra e logjistikës ku vinin kamionët për furnizime,
5 ngarkonin, shkarkonin mallra, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. A keni parë ndonjëherë vetura joushtarake të parkuara
8 brenda në oborr?

9 PË. Po faktikisht na asnjë veturë ushtarake nuk e kemi pasë.
10 Na i kemi pasë veturat civile të gjitha kanë qenë. Unë e
11 thashë edhe dje që na shtet nuk kemi pasë. Ushtri tonën të
12 rregullt nuk kemi pasë. Ajo ka qenë ushtri vullnetare
13 faktikisht. Qysh i kanë dhuru mjetet njerëzit me vullnetin e
14 mirë, ashtu edhe i kemi përdorë edhe mjetet. Dikush e ka pru
15 një veturë, dikush e ka pru një xhip, dikush ka pru diçka si
16 dhurata faktikisht se obligim nuk e ka pasë kurrkush. Ato kanë
17 qenë civile të gjitha. Nuk muj me thënë një me thënë kjo ka
18 qenë ushtarake.

19 PY. Pra, në disa nga videot, kishte kamion në oborr që hynin,
20 dilnin dhe parkoheshin, kështu?

21 PË. Po ka dhe disa vetura të vogla si kamionçina, për
22 shembull, tip kamionçinash tamam-tamam, me rimorkio, makina me
23 rimorkios që panë ne. Ishte një me ngjyrë blu që dilte nga
24 ndërtesat, pra, përveç kamionëve kishte dhe kamionçina, apo
25 jo?

1 PË. Po ka pasë faktikisht. Ato kamionçina kanë ardhë pi
2 Zvicre për ndryshe ngjyrat i kanë pasë ushtri zvicerane apo
3 ndryshe tabela nuk kanë pasë tabela ushtarake. Në shumicën e
4 veturave aty i kemi vozit pa tabela fare se nuk kemi pasë
5 drejtë me vu tabelat e ushtrisë shqiptare.

6 PY. Makina që përdorët ju nga Tiranë për në Kukës, ju
7 kujtohet çfarë ka qenë? Çfarë firme ka qenë?

8 PË. Ajo i ka pasë tabelat gjermane.

9 PY. Jo. Çfarë lloj automjeti ishte, jo targat, çfarë lloj
10 automjeti ishte?

11 PË. Ford Escort ka qenë.

12 PY. Kishte shumë makina të ngjashme me tuajën që hynin dilnin
13 dhe parkonin? Nuk po flasim tani për kamionët, as për
14 kamionçinat, po flas makina si e juaja që hynin e dilnin në
15 Kukës në 1999?

16 PË. Nuk e di. S'më kujtohet. Unë faktikisht nuk kam qenë te
17 dera aty me mbajt evidenca. Ju tregova dhe dje që shumicën e
18 kohës kam qenë në terren.

19 PY. Krejt e kuptueshme.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kam dhe një linjë tjetër me
21 pyetje. Maksimumi dhe pesë minuta.

22 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet kur vinin këto furnizimet, a
23 kishte xhaketa me lara apo jelek antiplumb që UÇK-ja i
24 magazinonte aty në Kukës? Xhaketa ushtarake, pra, a kishte
25 xhaketa ushtarake dhe jelek antiplumb të magazinuara aty në

1 Kukës?

2 PË. Xhaketa ushtarake ka pasë shumë bile, për antiplumb nuk e
3 di. Po mundet me ndodhë që ka pasë edhe antiplumb. Unë vetë
4 kam pru pi Gjermanie antiplumb kam pru në Shqipëri. Edhe ato
5 me aeroplan bile.

6 PY. A e dini, ju kujtohet sa jelek antiplumb sollët ju nga
7 Gjermania?

8 PË. Njëherë e di që i kam sjellë 20 copa. Ka qenë viti 1998.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'i
10 tregoj dëshmitarit një pjesë të shkurtër të deklaratës së tij
11 077875-TR-ET Pjesa 4, faqja 31.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
13 doni që ta ballafaqoni me deklaratën e mëhershme?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, për këtë arsye.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
16 në rregull.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pjesa 4, faqja 31. 31. Jemi në
18 faqen 31? Dhe pak më lart? Kam frikë se nuk është faqja e
19 duhur.

20 Ta gjej kolegu faqen e duhur, po ndërkohë unë po i bëj
21 një pyetje dëshmitarit lidhur me atë që sapo tha.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Vazhdoni, po jo lidhur me këtë temë. Bëni një pyetje tjetër.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, ju thatë që ju njëherë, në një rast, keni

1 sjellë 20 jelekë antiplumb. A keni sjellë më shumë - më fal -
2 ju thatë që njëherë keni sjellë 20 xhaketa ushtarake. Keni
3 sjellë xhaketa të tjera ushtarake nga Gjermania në raste të
4 tjera?

5 PË. Po. Unë kam qenë faktikisht kam punu për Fondin
6 Vendlindja Thërret dhe e kam pasë edhe një pjesë edhe të
7 furnizimit me pajisje ushtarake pi Gjermanie.

8 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues për rastet e tjera kur
9 keni sjellë xhaketat ushtarake nga Gjermania, kur kanë qenë
10 këto rastet e tjera?

11 PË. Po mundet me ndodhë që kanë qenë me dhjetëra raste, jo
12 vetëm një rast. Lufta ka zgjatë dy vjet. Na kemi fillu luftën
13 me pi zeros. Nuk kemi asgjë s'kemi pasë. E pej zeros është
14 deshtë me furnizue. Qysh kemi mujt edhe qysh i kemi pasë
15 mundësitë.

16 PY. Në fakt e kam vetëm për xhaketat ushtarake që keni sjellë
17 nga Gjermania në Kukës. Keni thënë që kanë qenë "me dhjetëra
18 raste", në të gjitha këto raste ju keni çuar apo keni dërguar
19 xhaketa ushtarake nga Gjermania për në Kukës? Këtë po
20 përpiqeni të thoni?

21 PË. Jo, më falni, nuk i kam dërgu u në për Kukës. Faktikisht
22 unë i kam dërgu për Tiranë i kam dërgu. Ku i ka dërgu Tirana
23 nuk e di. Unë e kam pasë destinacionin faktikisht deri në
24 Tiranë i kam angazhu shoferat. Ka ndodhë dhe me mijëra
25 uniforma, unë një kamion i kam pru në Tiranë edhe pi Tirane

1 mbasandaj ku i kanë çu, nuk e di.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Prokuror, që të jemi të sigurt që është i saktë transkripti në
4 faqen 34, rreshti 7:

5 "A e dini sa jelekë antiplumb ...".

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, aty ka dalë vetëm plumba në
7 transkript, po duhet të jetë shkruar jelekë antiplumb.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull. U korrigjua. Faleminderit.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në fakt, citimi që po
11 përpiqesha që të gjeja unë mund të jetë në faqen 29. Shkojmë
12 në fund të faqes.

13 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
14 këshillohen]

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Mund ta ndihmojmë ne.

16 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

17 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
18 këshillohet]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 fakt, një koment i përgjithshëm ky, është mirë që kur t'i
21 referoheni numrit të faqeve në të djathtë të faqes apo e keni
22 fjalën për numrin e PDF, se ndonjëherë numri i materialit që
23 keni ju në PDF nuk përkon me numrin e dokumenteve që kemi në
24 sistem.

25 Avokat, pashë që u çuat në këmbë.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Po është faqja 31 tek PDF, po 29
2 tek dokumenti origjinal. Po ne duam që të shfaqet dhe
3 dokumenti në shqip, ky është udhëzimi që keni dhënë ju, ZPS-ja
4 duhet të na japi edhe numrin e referencës në shqip që ta
5 lexojë dëshmitari. Kështu kemi vepruar deri tani. Dhe nuk shoh
6 asnjë arsye pse duhet ta ndryshojmë këtë praktikë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po mund t'i kërkojmë dhe
8 përkthyesve të na ndihmojnë që të përkthejnë fjalë për fjalë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
10 jo. Pajtohem me Avokatin edhe unë kam përgatitur dhe një email
11 që do jua dërgoja që gjithmonë t'i keni të dyja versionet,
12 sepse kjo është mënyra sesi punojmë ne. Kështu që mund të
13 ketë, sigurisht mund të bëjmë përjashtime me ndonjë video, por
14 dhe për hir të dëshmitarit duhet të shfaqet versioni në shqip
15 se është gjuha amtare e tij.

16 Kështu që unë pajtohem me Avokatin.

17 Kështu që po ju pyes a e keni njëherë si fillim.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, s'e kemi referencën për
19 anglishten. Kemi vetëm anglishten që fillon në fund të faqes
20 28.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
22 lejoj si përjashtim tani, por ama herën tjetër do ju lutesha
23 të bënit kujdes. Nuk po e dërgoj emailin që kisha përgatitur.
24 Meqë e thashë me zë, po ju lutem që ta respektoni udhëzimin që
25 sapo dhashë.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, do ta respektojmë udhëzimin
2 tuaj.

3 Ky është vendi ku mund të fillojmë.

4 PY. Z. Hoxha, kjo është një pjesë e intervistës suaj me ZPS-
5 në. Pjesa 4. Dhe janë diskutuar dhe jelekët antiplumb këtu me
6 ju. Ju ka pyetur Prokurori:

7 "A ju kujtohet -- më fal. Një sekondë.

8 "A ju kujtohet që tek furnizimet për logjistikë që
9 merrnit -- kalojmë në faqen tjetër, pra, "a ju kujtohet që tek
10 furnizimet që kishte drejtorja e logjistikës, a kishte atje
11 dhe xhaketa ushtarake apo jelekë antiplumb që UÇK-ja i kishte
12 magazinuar në Kukës?"

13 Dhe ju i jeni përgjigju:

14 "Po, ka pasur. Edhe unë kam dërguar me qindra syresh nga
15 Gjermania për atje. Është bërë një mbledhje dhe nuk mund t'ua
16 jepnim të gjithë ushtarëve, sigurisht".

17 Pra, fillimisht ju keni thënë që keni dërguar me qindra,
18 saktë?

19 PË. Po e thashë edhe para që i kam dërgu. Njëherë i kam pru
20 vetë në Tiranë 20 copa. Por në raste të tjera i kemi dërgu me
21 kamion faktikisht pej Gjermanie i kemi dërgu në Tiranë. Kanë
22 ndodhë me qindra.

23 PY. Dhe këtu nuk bëhet fjalë për Tiranën, këtu bëhet fjalë
24 për Kukësin. Po pyetja këtu është jelekë për jelekë antiplumb
25 të magazinuar në Kukës dhe ju i jeni përgjigjur dhe keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk (Vazhdim)

Faqe 39

1 thënë unë kam dërguar me qindra atje. Atje këtu nënkupton
2 Kukësin. Çfarë mund të thoni në lidhje me këtë?
3 PË. Direkt e në Kukës. Direkt e në Kukës unë s'kam dërgu
4 material ushtarak asnjëherë. Unë e kam kuftu faktikisht e kam
5 kuftu që kam dërgu pi Gjermanie për Shqipëri e jo direkt e në
6 Kukës. Se kur kam shku në Kukës as armatim nuk kam pasë
7 faktikisht, mbasandaj armatimin e kam marrë në Kukës. Se as
8 armatim temin personal nuk kam pasë në Tiranë, se në Tiranë
9 s'na u ka nevojit armatimi. S'kemi qenë në luftë me Tiranën o
10 me Serbinë.

11 PY. Në cilin vend, domethënë, saktësisht në cilin vend brenda
12 uzinës mekanike të Kukësit ishin magazinuar këto jelekë
13 antiplumb?

14 PË. A jo nuk e di. S'ka qenë obligim i imi ajo. Obligim i imi
15 ka qenë armatimi. Jo veshmbathjet, jo ushqimi, jo antiplumbi.
16 Unë e kam pasë vetëm armatimin e kam pasë si përgjegjësi.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Prokuror, kam unë një pyetje për sqarim.

19 Dëshmitar, a keni dërguar xhaketa ushtarake ju apo jelek
20 antiplumb nga Gjermania, cilën nga këto keni dërguar?

21 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, të dyja. Edhe xhaketa
22 ushtarake, uniforma ushtarake, po edhe antiplumb.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit. Mjafton.

25 Prokuror, fjala është për ju.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

2 PY. Kam edhe një pyetje të fundit lidhur me këtë temë. Pra,
3 ju nuk e dinit ku ishin, në cilin vend ishin magazinuar këto
4 jelekët antiplumb, po mbase ju keni parë jelek antiplumb në
5 ambientin e uzinës mekanike të Kukësit ju ka rastisur, pra, që
6 t'i shihni këto jelekët antiplumb? Dhe nëse i keni parë, ku i
7 keni parë në cilin vend?

8 PË. Unë ju tregova që nuk e di se në cilin vend kanë qenë
9 faktikisht të palume. Nuk e di. Nuk ka qenë detyrë e imja. Atë
10 obligim e ka pasë tjetërkush. Nuk e di kush e ka pasë a Latif
11 Fejzullahi apo Bedri Azemi, nuk e di. Unë kam pasë obligim
12 vetëm armatimin. Nuk jam përzi në punët e të tjerëve.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ora
14 11.00 pa pesë, Prokuror.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do konsultohem pak me kolegët.
16 Më jepni një minutë, ju lutem.

17 [Përfaqësuesit Prokurorisë këshillohen]

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë
19 përfundoj me pyetjet për këtë dëshmitar.

20 PY. Faleminderit, z. Hoxha.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Prokuror.

23 DËSHMITARI: Shumë faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
25 ju keni bërë pyetje përreth katër orë, kështu që është

1 respektuar orari në lidhje me pyetjet.

2 Z. Shala, më jepni një moment, një moment sa të mbaroj me
3 dëshmitarin. Do jua jap fjalën. Po një moment sa ta mbyllim me
4 dëshmitarin.

5 Dëshmitar, ne do bëjmë një pushim tani gjysëm ore deri në
6 orën 11.30. Megjithëse, të shoh njëherë si është planifikimi
7 që t'ju informojë dhe ju.

8 Mbrojtësi i Viktimave, a keni pyetje për dëshmitarin?

9 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
11 Mbrojtjen.

12 Mbrojtja a keni pyetje shtesë për dëshmitarin?

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, kemi. Po të shkurtra. Mbase
14 mund të kem vetëm një pyetje për një identifikim vendi, mund
15 të jetë shumë e shkurtër.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull.

18 Z. Dëshmitar, Tani do t'ju shoqërojnë jashtë sallës së
19 gjyqit dhe do ju shohim sërish në orën 11.30.

20 DËSHMITARI: Shumë faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Shala, tani e keni fjalën.

24 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuara Gjyqtare,
25 mendoj se i kemi dy pyetje për -- po do të konsultona me

1 Avokat edhe mendoj që kemi dy pyetje, jo një. Ju faleminderit.

2 Po do konsultohem me Avokatin.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Patjetër. Patjetër. Tani gjatë pushimit do keni mundësi të

5 konsultoheni. Avokati juaj mund të bëjë dhe tri dhe katër

6 pyetje. Nuk është fare problem.

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

9 Nëse s'ka gjë për të diskutuar me Trupi Gjykes për momentin?

10 Po shoh Prokurorinë. Mbrojtësi i Viktimave. Mbrojtja. Nuk ka

11 asnjëherë asgjë.

12 Bëjmë pushimin.

13 --- Pauza fillon në orën 10.57

14 --- Seanca rifillon në orën 12.19

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

16 se vini.

17 Po vazhdojmë pak më vonë, më thanë që kishin disa

18 vështirësi teknike për t'u lidhur me z. Shala, por

19 përfundimisht e arritëm ta bënim.

20 Shoh që ZPS-ja ka të njëjtën përbërje, Mbrojtësi i

21 Viktimave. Në anën time të majtë shoh një ndryshim të vogël.

22 Është kështu, z. Gilissen?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, jemi pothuajse të njëjtët

24 persona. Kam kënaqësinë t'ju prezantoj me znj. Melissa McKay

25 që është zyrtarja ligjore e re, dhe paraqitet këtu para jush

1 për herë të parë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Për procesverbal, z. Shala është këtu.

5 A më dëgjoni mirë z. Shala?

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë
7 mirë, faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Mbaruam me pyetjet e Prokurorisë.

11 Z. Prokuror, keni fjalën.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, kemi përfunduar me pyetjet
13 tona, megjithatë siç ju premtova përpara pushimit, duam të
14 shprehim qëndrimin tonë lidhur me dokumentet dhe Avokati që do
15 t'i caktohet dëshmitares që shpresojmë të dëshmojë nesër.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
17 doja që për këtë të kalojmë në seancë private.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Natyrisht.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
20 Sekretare na kaloni në seancë private, ju lutem.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë

15 publike.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

17 do të sjellim dëshmitarin në sallë, për vazhdimin e dëshmisë

18 së tij, dhe tani radhën do ta keni ju, Avokat Mbrojtës. E shoh

19 që pohoni me kokë.

20 Znj. Punonjëse, sillni dëshmitarin në sallë ju lutem.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Përshëndetje, z. Dëshmitar. Mirë se erdhët, z. Hoxha.

24 DËSHMITARI: Përshëndetje edhe juve.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

1 do t'ia jap fjalën Avokatit Mbrojtës përsëri, të cilët do ju
2 bëjnë disa pyetje shtesë.

3 Z. Avokat, fjalën e keni ju.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

5 Pyetje vijuese nga Z. Gilissen:

6 Z. GILISSEN: [Përkthim]

7 PY. Mirëdita z. Dëshmitar.

8 PË. Mirëdita.

9 PY. Atëherë, z. Dëshmitar, po flisnim për dhomën që ju
10 treguan në video dje, dhoma ku ishin, ku pjesëtarë të UÇK-së
11 të tjerë këndonin pas varrimit të Abdurrahman Gërdellaj. Për
12 nevoja të referencës, kjo është 21, te transkripti i 21
13 nëntorit 2023, faqja 3289, 3294. Në transkriptin e sotëm,
14 faqja 30, rreshti 6 deri në rreshtin 8. Thatë që keni fjetur
15 në zyrën e Latif Fejzullahut 95 për qind të kohës.

16 Që të jemi të qartë dhe të shmangim çdo keqkuptim, do të
17 doja, tani kërkoj tani të shfaqet në ekran fotografia me ERN -
18 -

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me leje të Gjykatës natyrisht.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
21 është arsyeja përse kërkon shfaqjen e kësaj fotografie?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është për, fotografi që e kemi
23 parë pardje, dje apo pardje, por pa shënimin që ka vënë
24 dëshmitari.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

1 është shumë e qartë për mua akoma, por vazhdoni.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është çështje identifikimi.

3 Nuk mendoj që është kjo.

4 PY. Atëherë, dëshmitar, a mund të shënoni ju lutem këtë
5 fotografi ku është Latif Fejzullahu, cila dritare, ku ka qenë
6 Latif Fejzullahu.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Avokat, e keni fjalën dhoma e z. Fejzullahu.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Së pari, zyra, sepse flet për
10 zyrën fillimisht, pastaj për dhomën sepse është dhoma ku janë
11 mbledhur për të kënduar, siç thotë ai. Kështu që së pari do
12 pyes për ku ishte zyra e z. Latif dhe pastaj ku ishte dhoma ku
13 janë mbledhur për të kënduar, pas varrimit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
15 kuptim, kjo është e qartë. Por në pyetjen tuaj nuk përmendët
16 vendin, përmendët vetëm emrin. Pyetja ishte ku ishte Latif
17 Fejzullahu, domethënë e kishit fjalën për zyrën. Në rregull, e
18 kuptoj.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim]

20 PY. A është e qartë për ju, z. Dëshmitar?

21 PË. Po, e qartë është. Këtu është e shënuar me numrin 2.

22 PY. Pra, a mund të themi që tek numri 2 është edhe zyra e
23 Latifit?

24 PË. Po, kjo është.

25 PY. A është ky vendi ku jeni mbledhur për të kënduar pas

1 varrimit të z. Gërdellaj?

2 PË. Po, kjo dhoma është.

3 PY. Faleminderit shumë.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbarova me këtë fotografi. Tani
5 mund të kaloj tek një temë tjetër.

6 Tani do të doja të shfaqet në ekran deklaratën e
7 dëshmitarit me ERN 077857-TR-ET, Pjesa 2 RED2.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Avokat, cili është qëllimi që filloni me këtë deklaratë? Nuk
10 keni ndonjë pyetje paraprakisht, pastaj t'i tregoni
11 deklaratën?

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, në tre pjesë të deklaratës,
13 dëshmitari pyetet, i kërkohet që të identifikojë në mënyrë të
14 përafërt një vend. Dhe kemi gishtin në mur aty, dhe do të doja
15 që t'i kemi versionin në shqip, natyrisht me referencën e
16 versionit shqip, dhe ta pyesim atë që të tregojë ku ishte
17 përafërsisht ky kamioni i famshëm për të cilin folëm më herët.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A nuk
19 keni një pyetje që t'i bëni dëshmitarit paraprakisht, përpara
20 se të kërkojmë shfaqjen e deklaratës?

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua që ai, atij do t'i kërkoja,
22 do ta pyes lidhur me mënyrën se si është kërkuar që të
23 identifikojë atë vend. Sepse sot iu paraqit në mënyrë të
24 përafërt mënyra se si është. Nuk i dëgjova fjalët. Është e
25 rëndësishme kjo pjesë. Se kamioni fillimisht ka qenë aty

1 përafërsisht tani është përballë afër murit. Gishti që
2 tregonte pothuajse çatinë e ndërtesës, dhe të gjithë pajtohemi
3 që kamioni nuk ishte në çati.

4 Kështu unë dua t'i propozoj dëshmitarit që ose të
5 konfirmojë ose jo që atij kur i është bërë pyetja për të
6 treguar se ku ishte kamioni, i është bërë pyetje që të tregojë
7 përafërsisht, jo me saktësi, ku ishte kamioni.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
9 por ky sqarim tani që e dhamë dhe gjithçka është përkthyer,
10 s'ka më pyetje se u përkthye shpjegimi dhe që ju parashtruat
11 për dëshmitarin. Tani mund të vazhdojmë por do të kishte qenë
12 më mirë që dëshmitari të largohet nga salla përpara se juve të
13 jepni këtë sqarim, e para.

14 E dyta, nuk do diskutoj me juve asnjëherë përmbajtjen e
15 pyetjeve tuaja, por mënyrën sesi i bëni pyetjet. Ky ishte i
16 vetmi problem për pjesën. Për sa i takon pjesëve të tjera do
17 t'ju jap fjalën gjithmonë, çdo herë që e kërkoni, por jo kur
18 unë jam duke folur. Dhe nuk do të them asnjëherë që s'keni të
19 drejtë për të folur.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe kjo është hera e parë më
21 duket, që besoj nuk gaboj këtu, që dëshmitari do të shohë
22 deklaratën e tij në shqip. Atij iu tregua versioni në
23 anglisht, ajo që ka thënë dhe ka dëgjuar në atë kohë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
25 lejoj këtë që të shfaqet, të shfaqet deklarata, megjithatë ju

1 rikujtoj se duke qenë që ju dhatë shpjegimin paraprakisht,
2 përgjigjja e dëshmitarit është pak e ngjyrosur sepse e keni
3 shpjeguar të gjithë kontekstin lidhur me këtë.

4 Znj. Sekretare, mund të shfaqni dokumentin në fjalë në
5 ekran.

6 Dhe, z. Avokat, që të kthehem tek komenti që bëtë ju, që
7 është hera e parë që i tregohet në shqip ky dokument. Ne
8 shfaqëm pjesë të videos ku ai dëgjohet që flet në shqip,
9 kështu që nuk është hera e parë për të që i tregohet diçka në
10 shqip.

11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Versioni në anglisht, do të doja
13 që dëshmitari të lexojë faqen 5, rreshtin 24, faqen 6, rreshti
14 5. Në veçanti rreshtin 25 -- jo, në fakt 23. Dhe pastaj në
15 faqen 7, rreshti 5, dhe rreshti që na intereson i fundit është
16 në faqe 7, rreshti 4. Natyrisht mund t'i përsëris dhe një herë
17 këto. Ky është versioni në anglisht. Dhe në versionin shqip
18 kemi faqen 6, rreshti 17 deri në faqen 7, rreshti 2.
19 Domethënë, faqe 6, rreshti 17, dhe përfundon në faqen 7,
20 rreshti 2. Pastaj përsëri në faqen 7, rreshtat 19 deri në 21,
21 janë edhe këto interesante.

22 Me leje të gjykatës --

23 PY. Z. Dëshmitar, a mund të lexoni pjesën që shikoni në
24 ekran.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj

1 që është më mirë që ta lexoni juve, sepse ne nuk mund të
2 kontrollojmë atë që lexon ai. Në qoftë se doni diçka që të
3 jetë në procesverbal, duhet ta lexoni.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Natyrisht do ta lexoj në anglisht
5 se aftësia ime në shqip është e kufizuar.

6 PY. Tani do fillojmë me faqen 5, rreshti 23.

7 "Z. Elderkin: Tani do përdor kamerën këtu për t'ju
8 treguar, dhe po tregoj vendin për afërsisht.

9 Faqja 6:

10 "Dëshmitari: Po.

11 "Elderkin: Do të kthej kamerën. Z. Hoxha, kjo është pak a
12 shumë, për afërsisht zona ku ka qenë kamioni i prishur. Tani po
13 ia tregoj kamerës.

14 Tani kalojmë në faqen 7, rreshti 3, në anglisht. Dhe:

15 "Tani ju po tregoni të njëjtin vend ku unë ju tregova dhe
16 me gisht, për afërsisht, pra bëhet fjalë për vendin
17 për afërsisht ku ka qenë kamioni i prishur. A është e saktë?"

18 Përgjigja juaj është:

19 "Po, e saktë."

20 Pra pyetja ime është shumë e thjeshtë. Z. Dëshmitar, kur
21 ju keni konfirmuar këtë të ashtuquajturin vend ku ka qenë
22 kamioni, ky kamion, keni bërë një konfirmim të përafërt,
23 domethënë keni folë për afërsisht me gishtin që është në
24 drejtim të murit të ndërtesës, pra është një tregim, keni bërë
25 një përcaktim të përafërt.

1 PË. Po, për afërsisht, për afërsisht. Në fakt aty ka qenë.
2 Saktësisht, faktikisht me gishta nuk mundesh me tregu, por,
3 faktikisht, aty ka qenë. Për afërsisht në qatë pjesë. Se ajo ka
4 qenë në mes, faktikisht. Prej murit e në këtë anë kanë qenë të
5 parkumë.

6 PY. Faleminderit shumë. Besoj që është shumë e qartë dhe më
7 mirë për neve.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe nuk kam pyetje tjetër.

9 Ju falënderoj, znj. Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, z. Avokat.

12 Shoh diçka të paqartë në transkript. Faqja 53, rreshti

13 19. "Gishti që tregon -- gishti që është në drejtim të
14 ndërtesës", besoj. Po, ndërtesës.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, kështu është. Znj. Gjykatëse,
16 faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Avokati Mbrojtës përfundoi pyetjet e tija për herë të dytë.

19 Ka diçka tjetër të veçantë që Prokuroria dëshiron të
20 trajtojë si rezultat i kësaj?

21 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne nuk kemi pyetje të tjera.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Mbrojtësi i Viktimave.

1 Z. LAWS: [Përkthim] S'kemi pyetje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
3 Dëshmitar, palët s'kanë më pyetje, as Mbrojtësi i Viktimave
4 dhe as anëtarët e Trupit Gjykues, Gjykatës. Kjo do të thotë që
5 dëshmia juaj përpara kësaj Gjykate përfundon këtu, në këtë
6 lëndë. Dëshiroj t'ju falënderoj për përpjekjet tuaja në këto
7 dy ditë e gjysmë të dëshmisë tuaj.

8 Ju kujtoj që nuk duhet të diskutoni dëshminë tuaj me
9 askënd, dhe ju uroj rrugë të mbarë në shtëpi. Znj. Punonjëse
10 do t'ju shoqërojë tani jashtë sallës.

11 DËSHMITARI: Ju faleminderit edhe juve. Keni qenë
12 korrektë.

13 [Dëshmitari largohet]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
15 do bëjmë pushimin e drekës. Propozoj që të vazhdojmë si në
16 vijim. Do bëjmë pushim tani deri në orën 14.00. Pastaj do
17 bëjmë një orë e gjysmë seancë, dhjetë minuta pushim, dhe
18 pastaj do komunikojmë për të parë nëse mund të bëjmë 20 minuta
19 shtesë, apo gjysmë ore shtesë pas pushimit dhjetë minutësh.

20 Për momentin bëjmë pushimin e drekës, seanca ndërpritet.

21 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.47

22 --- Seanca rifillon në orën 14.00

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
24 se u kthyet.

25 Z. Shala, mirëdita, a më dëgjon?

1 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] [E padëgjueshme]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
3 mund ta përsërisni dhe një herë se nuk ju dëgjuam?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë
5 mirë, faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
7 dëgjuam përkthimin. E dëgjuam që foli z. Shala, por nuk morëm
8 përkthimin.

9 Në rregull, në rregull. Një problem teknik. Faleminderit.

10 Në të djathtë Prokuroria është në të njëjtën përbërje, po
11 ashtu edhe Mbrojtësi i Viktimave. E njëjta gjë në të majtë.
12 Jo, kemi dy persona.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kemi Kailin Chen dhe Deborah
14 Jonas [Sipas përkthimit] që është bashkëngjitur ekipit tonë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, e morëm shënim.

17 Në rregull. Vazhdojmë tani me dëshminë e dëshmitarit 0441
18 [Sipas përkthimit], znj. Safete Hadërgjonaj.

19 I lutem Sekretares ta sjellë në sallë. Jo, më falni. Shoh
20 që është çuar në këmbë Prokurorja.

21 Ka diçka që doni ta diskutoni përpara se të fillojmë me
22 dëshminë? Po ju jap fjalën.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kam dy çështje të shkurtra
24 procedurale që dua të trajtoj me Trupin Gjygues.

25 E morëm shënim udhëzimin që dhatë ju, që kur t'i tregojmë

1 deklarata të mëhershme dëshmitarit, duhet t'i tregojmë dhe
2 anglishten edhe shqipen. Sidoqoftë, për Dëshmitaren 4440 ZPS-
3 ja nuk ka përkthime në shqip të intervistave me ZPS-në, sepse
4 i janë nxjerrë Mbrojtjes sipas rregullës 153, dhe nuk e kishim
5 për detyrim sipas kësaj rregulle që të jepnim dhe versionin në
6 shqip të këtij transkript.

7 Kështu që do të donim të na këshilloni tani si të
8 veprojmë. Ky është dëshmitar i Mbrojtjes, s'e di. Mbase
9 Mbrojtja ndërkohë ka qenë vetë në gjendje t'i përkthejë këto
10 deklarata. Apo do kërkon ju të nderuar Gjykatës që në këtë
11 situatë, duke marrë parasysh edhe afatin e shkurtër kohor që
12 kemi ne të bëjmë përkthimin me gojë të tyre. Cilado mënyrë që
13 ju gjykoni se është më e përshtatshme.

14 E trajtova këtë çështje tani për shkak të udhëzimit që
15 dhatë sot paradite.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Parimisht, parimet vlejné për të gjitha deklaratat e mëhershme
18 që kemi përdorur deri tani, kemi pasur gjithmonë dhe
19 anglishten, dhe shqipen.

20 Por nëse e kuptoj unë saktë, ju po thoni që ju nuk keni
21 përkthim në shqip të deklaratës, të kësaj deklarate?

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, këtë po them.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po në
24 qoftë se nuk është, nuk do ta bëjmë brenda natës. Përveç nëse
25 do ketë ndonjë përkthim nga ndonjë palë tjetër, por do

1 habitesha, do ishte diçka krejt e re për ne.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Konfirmojmë edhe ne që nuk ka
3 transkript në gjuhën shqipe, dhe kjo ka qenë arsyeja pse
4 kontaktua Zyrën Administrative që të merrnim përkthimin
5 zyrtar të transkriptit. Por ata me të drejtë thanë që ky do
6 jetë përkthim i një përkthimi, sepse gjuha origjinale në audio
7 ka qenë në shqip. Edhe Zyra Administrative nuk ofron shërbim
8 transkriptimi, zbardhje pra të teksteve.

9 Ne kontrolluam disa nga pjesët e caktuara të deklaratës
10 që mund të jenë të dobishme për ne, kështu që kur ka
11 ndonjëherë detaje që duhet t'i shohim me imtësi, apo kemi
12 kontestime për pjesë të caktuara të materialeve, të gjitha
13 palët do ta ballafaqojmë me audion, sepse e kanë të
14 regjistruar me zë atë që ka thënë dëshmitari. Kështu që do ta
15 ballafaqojmë atë me shkrim me audion.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
17 nëse e gjykoni të mjaftueshme -- të përshtatshme ju, se ne
18 kemi përkthyesit që janë të shkëlqyer edhe mund të ofrojnë
19 ndihmën që nevojitet në këtë rast.

20 Kjo është pika juaj e parë, Prokurore? Keni diçka tjetër?

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, shkurtimisht. Do të donim që
22 të kërkonim që të përfshihej në listën tonë të materialeve për
23 dëshmitaren 0441 [Sipas përkthimit], që vjen sot. Pra duam të
24 shtojmë tre përkthime të tri provave të fundit materiale që i
25 kishim përfshirë në listën e materialeve. Ne kishim një

1 përkthim paraprak, por u bë një përkthim më zyrtar i
2 materialeve. Prandaj duam që të përfshijmë në listën e
3 materialeve këto versione në gjuhën angleze dhe jemi në
4 procesin e nxjerrjes së këtyre materialeve.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
6 mund të konfirmoni ju që përkthimi që do të shohim në dokument
7 është njësoj si përkthimi zyrtar?

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Përmbajtja është njësoj, një nga
9 përkthimet është nga platformat e mediave sociale, ku
10 përkthehet automatikisht teksti. Ne sigurisht që donim një
11 përkthim zyrtar, por nga verifikimi që bëjmë ne, përkthimet
12 janë njësoj.

13 Mbrojtësi i Viktimave, doni të thoni diçka?

14 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Avokat, keni nevojë për fjalën?

17 Z. AOUBINI: [Përkthim] Jo, s'kemi kundërshtime. Dhe ne do
18 të donim t'i kishim përkthimet, përkthimin zyrtar do të donim
19 të kishim dhe ne, faleminderit për këtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Miratohet, pra, kërkesa juaj.

22 Edhe për faktin që s'u paraqit asnjë kundërshtim. Është
23 krejt normale që të kemi përkthimet zyrtare të një materiali
24 dhe nuk cenohet aspak Mbrojtja.

25 Në rregull. Kalojmë në seancë private?

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25

[Seancë private teksti i fshirë]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit.

16 Ju lutem, Asistente, sillni znj. Safete Hadërgjonaj që të

17 fillojmë me dëshminë. Znj. Hadërgjonaj do të japë dëshmi pa

18 masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.

19 Atëherë për sqarim do kemi seancën e radhës deri në orën

20 15.30.

21 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni

23 znj. Dëshmitare.

24 Mirëdita.

25 DËSHMITARJA: Mirëdita.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
2 se erdhët përpara Dhomave e Specializuara të Kosovës. A më
3 dëgjoni mirë?

4 DËSHMITARJA: Po, ju dëgjoj. Mirë se ju gjeta.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.
6 Shala, e dëgjoni dëshmitaren?

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e dëgjoj shumë
8 mirë, faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Dëshmitare, si jeni?

12 DËSHMITARJA: Mirë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot
14 do të fillojmë me dëshminë tuaj. Unë nuk e di pse duhet të
15 çonim fletëthirrje për të qenë ju e pranishme në sallën e
16 gjyqit, sidoqoftë iku tani, ja ku jeni.

17 Përpara se të fillojmë pyetjet për ju, unë do t'ju jap
18 disa këshilla.

19 Znj. Dëshmitare, jeni thirrur të jepni dëshmi përpara
20 Dhomave të Specializuara në çështjen gjyqësore Prokuroria e
21 Specializuar kundër Pjetër Shalës, që të ndihmoni Trupin
22 Gjykues që të dalë me një vendim.

23 Së pari, do të fillojmë me deklaratën solemne se do të
24 thoni të vërtetën. Më pas do t'ju bëjë pyetje ekipi i
25 Mbrojtjes së z. Shala që është në atë krah, me mantelet e kuq.

1 Pastaj përfaqësuesit nga Zyra e Prokurorit të Specializuar që
2 kanë ngjyrën e vjollcë, dhe më pas Avokati i Viktimave
3 pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore që është më pranë jush
4 në të majtën tuaj. Dhe më pas do të bëjmë pyetje dhe ne,
5 anëtarët e Trupit Gjykues.

6 Përpara se të bëni betimin se do të thoni të vërtetën, do
7 të jap disa këshilla praktike, lidhur me mënyrën se si do t'u
8 përgjigjeni pyetjeve.

9 Ju lutem, dëgjoni me vëmendje pyetjet. Nëse nuk e kuptoni
10 një pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet.

11 Ne duam të na thoni të vërtetën, të na thoni çfarë keni
12 parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar ju vetë. Nëse
13 diçka nuk e keni dëgjuar apo nuk e keni parë vetë, por e keni
14 mësuar në një formë tjetër, na e shpjegoni se si ka ndodhur.

15 Mbase nuk do ju kujtohen të gjitha detalet e ngjarjeve,
16 është krejt normale, veç ju lutem na thoni ato që ju kujtohen.
17 Mos hamendësoni, mos trilloni gjëra, mjaft të thoni "Nuk e
18 di", "Nuk më kujtohet".

19 Ju lutem, përgjigjuni vetëm pyetjes që ju kanë drejtuar.
20 Nëse kemi ne nevojë për sqarime, do jua bëjmë vetë pyetjen.

21 Po ashtu, ju kujtoj se keni të drejtën të kundërshtoni të
22 jepni dëshmi për aspekte që mund t'ju vetë-inkriminojnë në
23 bazë të rregullës 151(1) e Rregullores së procedurës dhe
24 provave.

25 Znj. Dëshmitare, a i kuptuat këto?

1 DËSHMITARJA: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë.

4 Tani, disa këshilla të tjera praktike. Ju lutem, kini
5 parasysh që çdo gjë që thuhet këtu përkthehet dhe zbardhet.
6 Është e rëndësishme që të flisni përpara mikrofonave, të
7 flisni qartë dhe të flisni ngadalë, në mënyrë që përkthyesit
8 të kapin çdo gjë. Dhe po ashtu është e rëndësishme që të
9 përgjigjeni vetëm pesë -- pasi ka mbaruar personi pyetjen, pra
10 pasi ju bëjnë një pyetje të prisni pesë sekonda në mendjen
11 tuaj, dhe pastaj përgjigjuni. Se ky pesë sekondëshi i jep
12 mundësi përkthyesve të përfundojnë fjalinë e mëparshme. Edhe
13 stenografit që të regjistrojë gjithçka. Dhe më pas ne mund të
14 vazhdojmë.

15 Nëse unë ngre dorën, siç po bëj tani, mos flisni më. Në
16 vend që të flas ngre dorën sepse nuk duhet të flasim
17 njëherazi. Ndonjëherë mund t'ju kërkoj që të largoheni nga
18 salla e gjyqit dhe do ju ndihmojë asistentja për këtë, sepse
19 mund të lindë nevoja të diskutojmë përmbajtjen e pyetjeve që
20 do t'ju bëjnë.

21 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim, ose nëse
22 ka ndonjë gjë tjetër që doni ta ndani me Trupin Gjygues,
23 ngrini dorën dhe unë do t'ju jap fjalën në momentin më të
24 përshtatshëm.

25 Dhe, së fundi, ndonjëherë mund t'ju kërkojmë të bëni

1 shënime në ekranin përballë. Keni një laps aty afër. Me atë
2 laps -- mund t'jua tregojë, do jua tregojë Asistentja e
3 Gjykatës. Me atë laps do bëni shënimet përkatëse nëse lind
4 nevoja.

5 I kuptuat këto?

6 DËSHMITARJA: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
8 mirë.

9 Si me çdo dëshmitar tjetër, tani do t'ju kërkoj të bëni
10 betimin se do të thoni të vërtetën. Dhe ju kujtoj se është
11 vepër penale të jepni dëshmi të rreme përpara Dhomave të
12 Specializuara. E kuptoni këtë?

13 DËSHMITARJA: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull.

16 Ju lutem, ndihmoheni tani dëshmitaren me tekstin që duhet
17 të lexojë.

18 Mund të lexoni me zë tekstin që keni përballë.

19 DËSHMITARJA: E ndërjegjeshme për rëndësinë e dëshmisë
20 sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do
21 të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën
22 dhe nuk do të mbaj të mfshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

23 DËSHMITARJA: W04441

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, znj. Dëshmitare, tani jeni nën betim për të

1 thënë të vërtetën.

2 Mbrojtja mund të fillojë me pyetjet e tyre.

3 z. Avokat keni një orë e gjysmë për të parashtruar
4 pyetjet tuaja. Në qoftë se ka ndryshim ndërkohë, na informoni
5 ju lutem.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
7 Gjykatëse.

8 Pyetje nga z. Gilissen:

9 Z. GILISSEN: [Përkthim]

10 PY. Mirëmbërëma znj. Dëshmitare. Faleminderit për praninë
11 tuaj. Kemi disa pyetje lidhur me disa tema që do t'ju
12 parashtrojmë. Besoj që duhet të jetë shumë e qartë për neve që
13 qëllimi i këtyre pyetjeve është që të marrim disa informacione
14 dhe të qartësojmë disa pika.

15 Tema e parë që do të doja të trajtoj me ju janë disa
16 pyetje personale. Një pyetje personale. A mund të na e jepni
17 emrin dhe mbiemrin tuaj ju lutem?

18 PË. Unë jam Safete Hadërgjonaj.

19 PY. Faleminderit. A keni apo a keni patur në të kaluarën
20 ndonjë pseudonim, nofkë?

21 PË. Jo, kurrë.

22 PY. Datëlindja dhe vendlindja, ju lutem.

23 PË. Unë kam lindë në fshatin Voksh, më 13 nëntor 1964, dhe
24 jetoj në Deçan që nga viti 1975.

25 PY. Faleminderit. Niveli i shkollimit tuaj ju lutem.

1 PË. Shkollën e mesme e kam kry në gjimnazin "Vëllezërit
2 Frashëri" në Deçan, drejtimi ekonomik. Fakultetin e kam
3 përfundu në fakultetin ekonomik në Universitetin e Prishtinës.
4 Po ashtu edhe magjistraturën e kam përfundu në fakultetin
5 ekonomik të Universitetit të Prishtinës, dhe doktoraturën po
6 ashtu e kam përfundu në fakultetin ekonomik në Prishtinë. Në
7 fakultetin -- në Universitetin Hasan Prishtina në Republikën e
8 Kosovës.

9 PY. Faleminderit. Përpara luftës së 1998, 1999, a keni patur
10 punë, a keni punuar?

11 PË. Po, kam punu. Pasi kam përfundu fakultetin ekonomik, në
12 vitin 1997, kam fillu punën në gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"
13 në Deçan, si mësimdhënëse e lëndëve ekonomike. Aty kam punu
14 shtatë vite, katër vite kam punu në institucionin e shkollës
15 në gjimnaz.

16 Pas, në vitin 1990, na e kanë mbyllë shkollën pushtuesit
17 serbë përmes policisë, na e kanë vu bllokadën në derë dhe kemi
18 mbetë jashtë nxënësit dhe profesorët dhe jemi detyru ta
19 organizojmë mësimin nëpër oda, në shtëpi private, ku kam punu
20 edhe katër vite aty.

21 Pastaj, pas vitit 1994, bashkë me vëllain tim, kemi hapë
22 një agjension turistik dhe kam punu deri në vitin 1998 kur
23 kanë ardhë policia e Serbisë dhe na e kanë mbyllë edhe atë
24 agjension dhe jemi detyru të mbyllemi në shtëpi.

25 Pas luftës kam punu në Zyrën e Kryeministrit si zyrtare

1 për çështje politike ku kam mbikëqyrë dy ministri, Ministrinë
2 e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë. Aty kam punu dy-tre
3 muaj dhe pastaj kam vazhdu si drejtoreshë e administratës në
4 Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

5 Në vitin 2004, jam bo pjesë e listës kandiduese për
6 zgjedhjet qendrore që janë mbajt në Kosovë. Dhe kam fitu, jam
7 bo deputete e kuvendit të Kosovës.

8 Prej vitit 2004 dhe deri në vitin 2019, unë kam qenë
9 deputete në kuvendin e Kosovës dhe njëkohësisht kam punu edhe
10 si ligjëruese në Kolegjin e Biznesit prej vitit 2013 deri në
11 vitin 2017.

12 Në vitin 2019, prej vitit 2019, nuk jam më deputete në
13 kuvendin e Kosovës, ku kam qenë pesë mandate, dhe tash punoj
14 si këshilltare për çështje financiare e grupit parlamentar të
15 Partisë Demokratike dhe jam profesoreshë me angazhim në
16 Universitetin Haxhi Zeka, jo e rregullt, por me angazhim.

17 Kjo ishte shkurtimisht ajo ku kam punue.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Avokat, dy gjëra desha të them.

20 E para, herën tjetër përmbajeni pyetjen ju lutem. Pyetja
21 ishte, çfarë keni bërë si punë përpara luftës. Dhe ndoshta
22 Avokati është i interesuar të dijë edhe çfarë keni bo pas
23 luftës, por pyetja ishte çfarë keni bo përpara luftës.
24 Përmbajuni pyetjes, ju lutem, dhe jepni përgjigje vetëm për
25 atë pjesë.

1 Pika e dytë është, nuk jam e sigurt nëse është
2 regjistruar diçka gabimisht në transkript apo është problem
3 përkthimi, apo thatë në një mënyrë që keni menduar ndryshe.
4 Thatë që:

5 "Në vitin 1997 keni filluar punën në 'Vëllezërit
6 Frashëri'..."

7 E keni pasë fjalën për 1997?

8 DËSHMITARJA: Jo, jo. Jo në 1997, jo. Por në vitin 1987.
9 Kur kam përfunduar fakultetin, unë jam përpjekë me u punësu
10 nëpër ndonjë ndërmarrje, por nuk kam pasë mundësi.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Mjaftojmë me kaq.

13 DËSHMITARJA: Jam pranë në gjimnaz --
14 [Folës që flasin njëkohësisht]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Mjafton me kaq, mjafton me kaq. Thjesht desha të di datën.
17 Edhe në këtë rast, ju lutem, përmbahuni pyetjes. Sepse
18 përndryshe mund të marrim më tepër informacion një pjesë e të
19 cilit ndoshta dhe nuk është relevant për neve.

20 Z. Avokati, e keni fjalën ju.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë, znj.
22 Gjykatëse.

23 PY. A mund të themi që jeni apo keni qenë figurë publike në
24 Kosovë?

25 PË. Pas luftës.

1 PY. Pas luftës. Faleminderit.

2 PË. Kam qenë deputete. Deputeti është figurë publike.

3 PY. Faleminderit. Ku keni qenë në 1998?

4 PË. Në vitin 1998 fillimisht kam qenë në shtëpi, në këtë vit
5 gjatë prillit dhe gjatë majit të vitit 1998 ka qenë një
6 gjendje tepër e tensionuar në Deçan, dhe në fund të majit,
7 gjatë muajit prill dhe maj nëpër Deçan kanë qarkullu forca të
8 mëdha ushtarake dhe policore, sepse e kam shtëpinë mu në breg
9 të magjistrales Pejë-Deçan-Gjakovë. Nji armatim që ka qarkullu
10 brenda këtyre dy muajve nuk e kam pa as në frontet e luftës në
11 Ukrainë. Disa janë pozicionu në Podin e Gështenjave prej nga
12 na vëzhgojshin neve.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
14 do t'ju ndërpres përsëri.

15 DËSHMITARJA: Në rregull. Kështu që --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
17 lutem, Avokati ju bëri pyetjen, ku keni qenë në 1998. Pra --

18 DËSHMITARJA: [Folës që flasin njëkohësisht]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Dëgjoni ju lutem, mos më ndërprisni se përndryshe është
21 problem edhe për përkthimin pastaj, sepse dëgjojnë dy zëra në
22 të njëjtën kohë dhe nuk dinë çfarë të përkthejnë.

23 Atëherë mos jepni hollësi, detale, të tepërta. Pyetja
24 ishte ku keni qenë në një periudhë kohore të caktuar dhe e
25 thoni thjesht, tregoni ku keni qenë. Në qoftë se ka nevojë për

1 hollësi të mëtejshme, ju bëhet pyetja vijuese. Në rregull?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe pyetja ime --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
4 kemi majin, prillin dhe majin, në qytet dhe detaje të tjera të
5 cilat për momentin nuk i shoh se janë relevante për këtë
6 pyetje dhe për këtë rast çështjeje. Përndryshe, po filluam në
7 këtë mënyrë nuk mbarojmë.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të --

9 [Folës që flasin njëkohësisht]

10 DËSHMITARJA: Atëherë, po jua jap përgjigjen shkurt.
11 Mirëpo ne nuk kemi dalë nga dëshira prej shtëpive tona. Në
12 fund të majit jemi detyru me i lëshu shtëpijat tona sepse ka
13 fillu policia me u futë shtëpijave dhe jemi dalë nga shtëpia
14 në fillim të qershorit. A të vazhdoj?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
16 bëjmë ndryshe tani. Në qershor ku keni shku, thjesht dua të di
17 ku?

18 DËSHMITARJA: Në fund të majit jemi nisë për Shqipëri.
19 Jemi ikë prej aty, kemi qëndru në pyll, disa kohë. sepse kemi
20 shku në një fshat, në fshatin tim të lindjes, në Voksh, me ikë
21 nga represioni i policisë dhe ushtrisë serbe. Fshati Voksh
22 është një fshat kufitar dhe prej aty kemi qëndru një ditë në
23 pyll. Mandej kemi kalu në Shqipëri, kemi shku në dy ditë, tri
24 ditë, faktikisht kemi bo rrugë. Kemi shku në Tropojë. Unë,
25 familja ime dhe disa anëtarë të tjerë të familjes nuk kemi

1 qendru atë natë në Tropojë, kemi shku në Bajram Curr, e kemi
2 marrë një furgon dhe kemi shku në Durrës.

3 Kështu që në fillim të qershorit ne jemi vendosë në një
4 fshat afër plazhit të Durrësit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
6 t'ia jap fjalën Avokati Mbrojtës. Dhe e kuptoj që nuk do të
7 jetë e lehtë të flasësh për këto gjëra, këtë periudhë kohore.
8 z. Avokati e keni fjalën juve.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Znj. Dëshmitare, a mund të na, a jeni në gjendje të na
11 jepni datën kur keni mbërritë në Shqipëri përmes kufirit?

12 PË. Sulmet në Deçan kanë ndodhë më datën 28, 29, 30. Me sa
13 mund të më kujtohet më datën 2, 3 ne kemi qenë në Durrës.
14 Qershor të vitit 1998.

15 Se është pak edhe e vështirë t'i kujtojmë datat dhe të
16 them të drejtën e kemi dhe pak vështirë të rikthehemi në atë
17 kohë sepse kemi përjetu gjëra të vështira dhe nuk duam fort
18 edhe t'i kujtojmë.

19 PY. E kuptoj këtë dhe e respektoj këtë. Është e rëndësishme
20 të jemi të vetëdijsëm për këtë gjë, dhe vuajtja dhe faji dhe
21 dënimi, kjo është fryma me të cilën, për të cilën shumë njerëz
22 kanë luftuar.

23 A jeni në gjendje të na jepni datën e arritjes tuaj në
24 Durrës?

25 PË. Po ka qenë diku 2 qershori, me sa mundena me e mbaj

1 mend. I vitit 1998.

2 PY. Faleminderit. Dhe deri kur ndejtët në Durrës, sa kohë?

3 PË. Në Durrës kam qëndru deri në fund të korrikut të vitit

4 1999. Pasi është çliru Kosova kemi qëndru edhe disa ditë atje

5 sepse nuk kemi pasë ku me u thy, se gjithçka ka qenë e djegur.

6 Por datën e saktë nuk e di. Nuk e mbaj mend kurrë. Por fundi i

7 korrikut e di që ka qenë.

8 PY. Faleminderit. Gjatë kësaj kohe që qëndruat në Durrës, a

9 jeni largu ndonjëherë nga Durrësi për të shku diku tjetër, për

10 ndonjë udhëtim apo diçka të tillë?

11 PË. Si po mendon, nëpër Shqipëri apo jashtë Shqipërie?

12 PY. Në Shqipëri ose diku tjetër. Pyetja ime është e

13 përgjithshme.

14 PË. Në Shqipëri unë kam lëvizë, jemi vendosë në fshatin

15 Arapaj, që është një fshat afër plazhit të Durrësit. Dhe

16 lëvizja ime aty ka qenë në këtë fshat dhe deri në Durrës, me u

17 furnizu me gjëra ushqimore apo gjëra të tjera. Dhe krejt çka

18 kam mujtë me lëvizë aty ka qenë me shku dhe deri në Shkozë që

19 ka qenë një 2-3 km larg prej fshatit ku kemi banu na, sepse

20 janë vendosë aty disa axhallarë të mi, i kemi vizitu për një

21 periudhë të shkurtër të kohës sepse ata kanë ikë jashtë

22 shtetit mandej. Jashtë Shqipërie me ato gomonet që kanë qenë

23 atëherë, janë dalë jashtë.

24 Dhe kam qenë pak herë në Tiranë. Sepse mundësitë e

25 lëvizjes ishin pak të vështira, se s'kishim mjete me lëvizë,

1 sepse gjithçka na kish mbetë në shtëpi dhe s'kishim as mjete
2 me lëvizë. Domethënë kaq ka qenë lëvizja ime nëpër Shqipëri.
3 PY. Faleminderit. Gjatë kësaj periudhe kohore, me ç'a jeni
4 marrë, a keni pasë ndonjë aktivitet të veçantë, konkret, në
5 Shqipëri apo çfarë keni bo?

6 PË. Jo, s'kam pasë ndonjë aktivitet. Në fshatin ku jemi
7 vendosë ne kryesisht kanë qenë diku rreth pesë, gjashtë,
8 fshatra të regjionit të Vokshit që janë vendosë aty, dhe
9 kryesisht me ata jemi marrë, ku po vendosen, si po vendosen,
10 dhe me menaxhu dhimbjet e tyre, se dikujt iu kishin vra
11 njerëzit. Dikush nuk e dinte ku i ka fëmijën, dikush kështu,
12 dikush ashtu, nga represioni i policisë dhe ushtrisë serbe që
13 e ka bo në regjionin tonë në ato fshatrat e regjionit të
14 Vokshit, që janë në kuadër të komunës së Deçanit. Nuk jam
15 marrë me ndonjë aktivitet, s'kam qenë pjesë e ndonjë
16 organizate.

17 PY. Gjatë kësaj periudhe kohore a keni qenë pjesëtare e UÇK-
18 së?

19 PË. Për fat të keq nuk e kam pasë atë fat me qenë ushtarë e
20 UÇK-së dhe me mbajtë krenarinë e të qenit ushtarë e Ushtrisë
21 Çlirimtare të Kosovës.

22 PY. Faleminderit. A keni qenë ndonjëherë në Kukës apo në
23 qytetin e Kukësit në Shqipëri, në veri të Shqipërisë?

24 PË. Jo, kurrë. Asnjëherë.

25 PY. Kemi prova në këtë dosje që, provë materiale, që ju

1 nxjerrin juve në Kukës në pranverë të 1999, dhe do të doja
2 reagimin tuaj në lidhje me këtë informacion.

3 PË. Unë në fillim e dhashë një deklaratë në betim dhe po e
4 them nën betim, kurrë, kurrë, kurrë në jetën time, as një
5 sekondë, as një minutë, nuk kam qenë në Kukës.

6 PY. Faleminderit shumë. Shumë e qartë. A keni qenë ndonjëherë
7 në ndonjë shtab të UÇK-së gjatë luftës?

8 PË. Asnjëherë, në asnjë shtab. Sepse unë nuk kam qenë në
9 Kosovë.

10 PY. Dua që të jem i qartë dhe t'i qartësojmë të gjitha
11 mundësitë. A keni dhënë ndonjë kontribut në çfarëdo forme
12 qoftë i përpjekjeve për luftën, gjatë luftës, në ndihmë të
13 luftës, gjatë kësaj periudhe?

14 PË. Nga vendi ku isha unë nuk kam pasë mundësi me i dhanë
15 direkt ndonjë kontribut për luftën, kryesisht iu kam ndihmu
16 familjeve që janë qenë në atë fshatin Arapaj, me menaxhu
17 situatat e vështira emocionale, për fëmijët e vet të cilët iu
18 kishin vra në luftë, dhe me gjetë mënyrën me ju ndihmu, sepse
19 kish njerëz që nuk kishin asnjë para me vete, s'kishin asnjë
20 gja të marrun nga Kosova, dhe kryesisht jemi marrë me njerëzit
21 e atij fshati aty. Asnjë gja tjetër.

22 PY. Faleminderit. A keni ba ndonji, a keni ba ndonjëherë ju
23 vetë ndonjë trajnim për çështje, për aftësim mjekësor dhe a
24 keni dhënë ju ndonjë ndihmë mjekësore dikujt?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Sqaroni kur.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në terma të përgjithshëm, a keni
3 bo ndonjë trajnim mjekësor, apo diçka të ngjashme?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
5 është relevante në qoftë se themi që bëhet për në 2010, për
6 shembull?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe përpara.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Përpara.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është më e qartë.

11 Ju kuptoj, shumë e qartë. Atëherë, përpara luftës.

12 DËSHMITARJA: Z. Avokat, unë as para lufte as gjatë lufte,
13 as pas lufte, asnjë trajnim nuk e kam bo për shëndetësi. Unë
14 jam ekonomiste. Unë kam ba shkollën për ekonomi dhe pas lufte
15 kam bo trajnime për ekonomi. Unë nuk kam lidhje me shëndetësi.
16 Krejt çka kuptoj në shëndetësi është me pi Paracetamol kur më
17 dhemb koka. Nëse nuk më pushon, me ikë vrap te mjeku.

18 Sa i përket shëndetësisë, kështu për qartësimin e juve,
19 unë pas lufte me një projekt të cili ka qenë nga AER-i e kam
20 përfunduar në fakultetin ekonomik magjistraturën që është
21 magjistër në menaxhmentin shëndetësor. Mirëpo, kjo nuk ka të
22 bëjë aspak me profesionin e mjekut. Këtë e kam përfunduar në
23 vitin 2008 me financimin e AER-it, por ka të bëjë me
24 menaxhimin shëndetësor, me caktimin e buxhetit, me organizimin
25 e institucioneve.

1 Por me profesionin e mjekut, as kam kry trajnime, as kam
2 qenë kurrë e angazhume në këtë drejtim. Dhe nuk kam lidhje me
3 profesionin e mjekut.

4 PY. Shumë e qartë. Faleminderit. Besoj që e njëjta gjë vlen
5 edhe për trajnime për t'u bo motër medicinale, apo për të bo
6 shërbime të tilla që bëjnë motrat medicinale?

7 PË. Unë kurrë nuk kam ba trajnim për motër medicinale, nuk,
8 nuk kam lidhje me motër medicinale. Kurrë në jetën teme s'kam
9 kry nonji shërbim as nanji trajnim sa i përket motrës
10 medicinale. Unë nuk di asnji gja në profesionin e mjekut.

11 Nëse më pyet për profesionin e ekonomistit, unë mund të
12 përgjigjja deri nesër në mëngjes. Por për mjek, nuk kam lidhje
13 me profesionin e mjekut.

14 PY. Që të jem i sigurt se nuk e di a e dëgjova me kujdes, a
15 keni qenë ndonjëherë në ndonjë vend ku, të UÇK-së, në
16 Shqipëri? A keni qenë ndonjëherë në një vend të tillë, vend
17 shtab, apo vend i UÇK-së në Shqipëri?

18 PË. Jo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
20 pyetje u bë dhe përgjigjja ishte e qartë.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Doja të saktësoja edhe për
22 Shqipërinë, për këtë arsye e ribëra pyetjen.

23 DËSHMITARJA: Z. Avokat. Jo, jo, asnjiherë, kurrë.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim]

25 PY. Besoj që është shumë e qartë. Faleminderit shumë.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për pyetjen e radhës do të,
2 mendoj që është më mirë të kalojmë në seancë private sepse ka
3 të bëjë me identifikimin e një personi.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull.

6 Znj. Sekretare na kaloni në seancë private ju lutem.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit, znj. Sekretare.

22 Z. Avokat, e keni fjalën juve.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim]

24 PY. Znj. Dëshmitare, a keni njohur apo e njihni një person me

25 emrin Pjetër Shala?

1 PË. Personin Pjetër Shala, emrin e tij për herë të parë, dhe
2 figurën e Pjetër Shalës për herë të parë e kam pa atë ditë që
3 e kanë arrestu Dhomat e Specializuara. Kurrë përpara nuk e kam
4 pa. As kurrë nuk e kam dëgju emrin e tij.

5 Kështu që, kur kam marrë ftesën nga Gjykata, që e kam
6 hapë ftesën dhe e kam pa që do të marr pjesë në procesin si
7 dëshmitare për Pjetër Shalën, për mu ka qenë edhe e
8 befasishme, por edhe qesharake, sepse ishte një njeri që kurrë
9 në jetën time nuk e kam pa.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem znj. Dëshmitare, përqendrohuni tek pyetjet. Nuk jeni
12 këtu për të shtjelluar temat që ju mendoni janë të arsyeshme.
13 Është hera e tretë që po ju jap këtë udhëzim dhe po jua
14 kujtoj, kështu që do t'ju ndërpres në qoftë se bëni përsëri
15 këtë gjë. Dhe nuk kam qejf që t'ju ndërpres.

16 z. Avokati e keni fjalën ju.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]

18 PY. Atëherë, znj. Dëshmitare, a e njihni një person apo a
19 keni njohur një person me pseudonimin Ujku, veçanërisht gjatë
20 periudhës së luftës 1998, 1999, a e keni pasë ndonjëherë
21 ndonjë informacion lidhur me një person të ashtuquajtur Ujku?

22 PË. Jo, asnjëherë. Kurrë.

23 PY. Atëherë, tani më mbetet t'ju falënderoj për praninë tuaj
24 këtu, për përgjigjet tuaja të qarta. Nuk kam pyetje të tjera
25 për juve.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Falënderoj Gjykatën që më dha
2 mundësinë të parashtroja këto pyetje, dhe kaq.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit, z. Avokat.

5 Tani, kemi akoma kohë, na ka ngelur akoma ca kohë deri në
6 momentin e pushimit.

7 Znj. Prokurore a jeni në gjendje të vazhdoni ju me
8 pyetjet tuaja?

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani,
11 znj. Dëshmitare, do t'ia jap fjalën Zyrës së Prokurorit të
12 Specializuar të cilët do t'ju parashtrojnë pyetjet e tyre. Në
13 rregull?

14 DËSHMITARJA: Në rregull. Do të përpiqem t'i respektoj
15 rregullat që m'i thatë ju.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Fjalë e keni ju, znj. Prokurore.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
20 Gjykatës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, që të jemi të sigurt, urdhri gojor që miratova më
23 herët, në fillim, kishte të bënte dhe me kërkesën që keni bë
24 më 28 nëntor, lidhur me materialet e -- më 20 nëntor
25 materialet e nxjerra që përfundojnë me 374, 376, 377? Sepse

1 kam përshtypjen që janë në listë, dhe që ju keni dorëzuar një
2 kërkesë në atë moment, ne i kemi pranuar, por nuk janë futur
3 në dosje akoma.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Në qoftë se e keni fjalën për
5 tre materialet në vetvete. Po. Këto materiale janë nxjerrë dhe
6 i kemi përfshirë këto në listën e materialeve që do t'i
7 përdorim në Gjykatë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
9 i kemi përmendur dhe kjo, ky shkëmbim emaili, dhe kjo kërkesë
10 janë tashmë në dosje. Që të kemi gjithçka të qartë, të shënuar
11 në procesverbal.

12 Mund të vazhdoni, znj. Prokurore.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

14 Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo:

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

16 PY. Mirëdita, znj. Dëshmitare. Unë quhem Gaia Pergolo. Jam
17 një nga Prokuroret, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe
18 kam disa pyetje për ju sot pasdite, për të parë dhe për të
19 kuptuar më mirë atë që thatë më herët.

20 Pak më herët thatë se keni lindur në Voksh, nëse e kam
21 kuptuar siç duhet. Dhe desha t'ju pyes pikë së pari, në cilën
22 komunë, në cilën komunë është Vokshi?

23 PË. Vokshi është në komunën e Deçanit. Është diku 5
24 kilometra, 6, prej Deçanit.

25 PY. Sa larg është Vokshi nga fshati Junik?

1 PË. Vokshi duhet me qenë edhe nja 6-7 kilometra prej fshatit
2 Junik larg, por unë nuk kam jetu në Voksh. Unë që e re, e
3 vogël, kemi dalë në Deçan, kur kam qenë në moshën 10 vjeçe.
4 Kam jetu në Deçan. Nuk kam Jetu në Voksh.

5 PY. Faleminderit për sqarimin. Kam një pyetje tjetër.
6 Atëherë, Deçani sa larg është nga Cërmjani? E di, e njihni
7 këtë fshat që po ju pyes?

8 PË. Të them të drejtën, nuk e di sa kilometra i ka. Deçani me
9 Gjakovën i ka diku 18 a 19 kilometra, por në Cërmjan s'kam
10 qenë kurrë. Nuk di ku është.

11 PY. Cërmjani është po ashtu pjesë e komunës së Deçanit? A e
12 dini?

13 PË. Jo, Cërmjani është, me sa di unë, është pjesë e komunës
14 së Gjakovës.

15 PY. Faleminderit.

16 PË. Dhe unë atje s'kam qenë kurrë.

17 PY. Shumë faleminderit. Pak më parë na thatë që keni qenë
18 mësuese, për disa vite. Po përpigem ta gjej dhe ku është
19 referenca. Se ju përmendët një shkollë, përmendët shkollën ku
20 keni dhënë mësim. Është në faqen 70 të transkriptit të ditës
21 së sotshme. Më duket dy -- rreshtat e parë. Gjimnazi
22 "Vëllezërit Frashëri"?

23 PË. Po. Në Deçan është.

24 PY. Faleminderit. Pra, ju keni dhënë mësim atje, por në cilat
25 vite? Mund të na e thoni pak ta konfirmoni dhe një herë?

1 PË. Në vitin 1987 deri në vitin 1994.

2 PY. Faleminderit. Po ashtu thatë pak më parë, ju shpjeguat se
3 në qershor 1998 shkuat në Shqipëri, saktë?

4 PË. Po.

5 PY. Po ashtu na thatë, përmendët, disa vende në Shqipëri ku
6 kishit shkuar, edhe thatë se asnjëherë nuk keni shkuar në
7 qytetin e Kukësit, saktë?

8 PË. E saktë, asnjëherë.

9 PY. A e dini ju, a keni dijeni, të paktën që ka pasë një bazë
10 apo shtab UÇK-ja atje në vitin 1999, që i përkon të njëjtës
11 periudhë kohore kur keni qenë dhe ju në Shqipëri?

12 PË. Asnjëherë s'kam pasë informatë të tillë.

13 PY. S'e keni ditur atëherë, apo s'e mësuat asnjëherë këtë
14 informacion edhe pas luftës?

15 PË. Asnjëherë. As nuk e kam ditë, as nuk e kam mësu, derisa
16 kanë fillu këto proceset gjyqësore kështu. Nga as te një
17 njeri, as te një burrë, as një gru, as një djalë, as një
18 vajzë, kurrë nuk ma ka përmendë që ka një gja të tillë atje.
19 Unë nuk kam dijeni.

20 PY. Mos e morët vesh përmes mediave atëherë, në ndonjë moment
21 të caktuar kohor?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ju
23 sugjeroja të bënit pyetje të hapur.

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po e riformuloj pyetjen.

25 PY. Ju thatë që nuk keni ditë asgjë, as nga burrë, as nga

1 gra, as nga fëmijë. Dhe as nga burime të tjera.

2 Unë po ju pyes tani, a ka pasur ndonjë burim tjetër
3 informacioni ku të keni mësuar për bazën e UÇK-së në Kukës?

4 PË. Nuk kam ndonjë dijeni. Nuk di.

5 PY. A keni dëgjuar për dy gjyqet publike, një kundër Sabit
6 Gecit dhe gjyqi tjetër kundër Xhemshit Krasniqit, keni dëgju
7 ndonjëherë për këto dy gjyqe, lidhur me ngjarjet në Shqipëri?

8 PË. Nuk po më kujtohen.

9 PY. Pra, s'keni dëgjuar, s'keni dëgjuar asnjëherë për këto
10 gjykime që përmenda?

11 PË. S'po më kujtohen. Nuk e kam dëgju. Nuk di.

12 PY. Faleminderit. Tani do ju pyes për disa persona nëse i
13 njihni.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Për pjesën e parë, të nderuar
15 Gjykatës, do lutesha të kalonim shkurtimisht në seancë private
16 dhe do jap edhe arsyet për këtë kërkesë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
18 mirë.

19 Sekretare e Gjykatës të kalojmë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

16 Prokurore, vazhdoni.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

18 PY. Zn. Dëshmitare, a e njihni një grua me emrin Fitnete

19 Ramosaj? Ju kërkoh ndjesë në qoftë se shqiptimin e kishim të

20 paqartë. Por uroj që e keni të qartë për kë e kam fjalën.

21 PË. Po, e kam njoftë. Por ajo nuk jeton tash. Lavdi pastë, ka

22 qenë një aktiviste jashtëzakonisht e mirë. E kam pasë, e kam

23 njoftë si nxanëse kur unë kam qenë profesreshë.

24 PY. Nga ishte ajo, prej nga ishte?

25 PË. Ajo ishte e fshatit Carrabreg.

1 PY. Ku është fshati Carrabreg?

2 PË. Fshati Carrabreg është 1 kilometër a dy prej Deçanit ku
3 unë jetoj. Janë fshatra të lidhura mes veti.

4 PY. Keni dijeni nëse ka qenë dhe ajo anëtare e UÇK-së gjatë
5 luftës?

6 PË. Unë Fitneten e njof vetëm si nxanëse kur ka qenë në
7 gjimnaz, unë kam qenë profesoreshë. Dhe i kam dhanë mësim
8 asajna. Pasi e ka krye ajo gjimnazin, unë nuk kam ndonji
9 informatë në lidhje me të.

10 PY. A e keni takuar ndonjëherë më pas kohës së shkollës?

11 PË. Nuk më kujtohet që e kam taku, nuk e di. Ndoshta nëpër
12 ndonjë tubim ku ka mbajtur ndonji fjalim, kam qenë pjesë e
13 tubimit, por nuk më kujtohet që jam taku me bisedu me të.

14 PY. Ju përmendët një tubim ku paska dhënë fjalime siç e
15 kuptova unë. A mund të na thoni ku ka ndodhur ky tubim, si nga
16 vendi, pra, si fillim ku është mbajtur ky tubim?

17 PË. Po thashë, saktësisht nuk mujna me e kujtu se është kohë
18 e gjatë, por ajo më kujtohet që menjherë pas lufte diku ka
19 mbajtur fjalim. Ka lexu fjalim për dëshmorët. Unë e kam pa prej
20 së largëti dhe nuk kam pasë rast me bisedu me të.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të kem
22 ndonjë problem teknik, por nuk po punon transkripti. Ka ngelur
23 në rreshtin 17.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
25 për ne s'po punon. Edhe Mbrojtja thotë që s'po punon

1 transkripti.

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
3 këshillohen]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
5 punon, po punon prapë. Të paktën ne po na punon.

6 Okej, Prokurore, po e shikon?

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, po. Po punon, po punon.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
9 gjithëve po u punon tani, në rregull.

10 Mirë, vazhdoni.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

12 PY. Pra, Dëshmitare, ju përmendët një fjalim menjëherë pas
13 luftës. A ju kujtohet në cilin vend është mbajtur ky tubim ku
14 dha fjalimin ajo?

15 PË. Nuk më kujtohet.

16 PY. Përveç këtij tubimit, gjatë luftës, e ke takuar
17 ndonjëherë?

18 PË. Jo. S'kam pasë ku me e takue. Kam qenë në Shqipëri.

19 PY. Ju thatë që ajo mbajti një fjalim. Në përgjigje të
20 pyetjes sime, a ka qenë e përfshirë me UÇK-në, ju thatë që dha
21 një fjalim për dëshmorët e kombit.

22 A keni ndonjë dijeni qoftë drejtpërdrejt prej saj apo nga
23 burime të tjera, nëse vërtet ka qenë e përfshirë me UÇK-në
24 gjatë luftës?

25 PË. Unë nuk kam ndonjë dijeni se vetë nuk kam qenë në UÇK dhe

1 nuk i di njerëzit se kush ka qenë dhe kush s'ka qenë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Prokurore, shoh që është çuar Avokati në këmbë.

4 Avokati, fjala është për ju.

5 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

6 Kam një kundërshtim. Besoj se kemi parë një, kemi parë
7 disa pyetje tendencioze që kanë 15 e 20 minuta që vazhdojnë
8 tani. Nuk po e shohim fare relevancën në gjithë këtë. Nuk e
9 shoh, nuk e konsiderojmë këtë as si një përpjekje për të vënë
10 në dyshim besueshmërinë. Unë nuk e kuptoj dot.

11 Ka dalë përtej kuadrit. Po thotë thashethem pas
12 thashethemi çfarë është dëgjuar. Ne nuk e trajtuam këtë temë.
13 Nuk buron prej nesh. Dhe kjo është diçka që cenon
14 besueshmërinë e dëshmitares. Nëse kanë diçka për ta
15 ballafaquar dëshmitaren, le ta bëjnë. Por nuk po e kuptojmë ku
16 do të dalin. Ka zgjatur shumë, nuk duhet ta kishit lejuar kaq
17 gjatë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
19 vendos unë sa gjatë ka qenë. Megjithatë, e marr parasysht
20 kundërshtimin tuaj, Avokat.

21 Znj. Prokurore, në fakt unë i lejova pyetjet, por edhe ne
22 mendojmë se ka ardhë momenti ta përfundoni këtë pistë
23 pyetjesh.

24 Nuk pajtohem me Mbrojtjen, por nga ana tjetër mendoj se
25 duhet ta përmbyllni këtë pjesë. Ose bëjeni të qartë pse është

1 e nevojshme të vazhdoni me këtë linjë pyetjesh.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Unë në fakt isha duke e mbyllur
3 këtë temë.

4 Pyetjet synojnë të vënë, të testojnë besueshmërinë e
5 dëshmitares, dhe po përpiqeshim të krijojmë një panoramë më të
6 qartë në raport me dëshmitë e tjera që kemi ne në dosjen
7 gjyqësore. Megjithatë, po e lëmë me kaq.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

11 PY. Znj. Dëshmitare, kam edhe disa pyetje për një person
12 tjetër. A e njihni një person me emrin Muhamet Tafili?

13 PË. Jo.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
15 Prokurore, është gati ora 15.30. Ju lutem, përpiquni ta
16 përfundoni tani pyetjen, mund të bëni dhe një pyetje nëse
17 keni. Bëjmë dhjetë minuta pushim dhe do vazhdojmë për gjysmë
18 ore tjetër.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Në rregull.

20 PY. Keni dëgjuar ndonjëherë për këtë mbiemër, këtë mbiemrin?
21 Tafili?

22 PË. Jo.

23 PY. Faleminderit.

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Tani mund ta mbyll pyetjen, mund
25 ta mbyll linjën time të pyetjeve. Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull.

3 Znj. Dëshmitare, do bëjmë vetëm dhjetë minuta pushim
4 tani, dhe do të vazhdojmë dhe për gjysmë ore tjetër, deri në
5 orën 16.20. Në rregull? Do ju shoqërojë Asistentja e sallës së
6 gjyqit jashtë.

7 DËSHMITARJA: Në rregull.

8 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. Bëjmë dhjetë minuta pushim.

11 --- Pauza fillon në orën 15.28

12 --- Seanca rifillon në orën 15.43

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
14 se vini. Tani do vazhdojmë.

15 Znj. Punonjëse e Gjykatës, na sillni dëshmitaren në
16 sallë, ju lutem.

17 Sa, dhe sa kohë ju duhet znj. Prokurore?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Besoj që do përfundoj brenda
19 gjysmë ore, në mos më herët. Biles ka shumë gjasa të mbarojmë
20 para, më herët se gjysmë ore.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
25 se erdhe, znj. Dëshmitare. Tani do t'ia jap fjalën Prokurorisë

1 që të vazhdojnë me pyetjet e tyre.

2 DËSHMITARJA: Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Prokurore, ajo që konstatova është që deri tani keni përdorur

5 të njëjtën sasi kohore që përdori Mbrojtja. Dhe në qoftë se

6 pyetjet tuaja vazhdojnë të jenë relevante, do t'i lejojmë.

7 Por, duhet ta dini që duhet t'i kërkonte leje Panelit në qoftë

8 se tejkaloni kohën që ka përdorur Mbrojtja.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse. Do
10 të zbatoj udhëzimet tuaja.

11 PY. Znj. Dëshmitare, kam disa pyetje lidhur me përkatësinë

12 tuaj politike. A keni qenë ndonjëherë pjesë, anëtare apo

13 aktiviste në një parti politike në Kosovë?

14 PË. Unë që nga viti 1999 jam anëtare e Partisë Demokratike të
15 Kosovës.

16 PY. A keni patur, mbajtur ndonjë rol formal në këtë parti?

17 PË. Po.

18 PY. Cili? Apo cilat?

19 PË. Në vitin 1999, ne kemi marrë iniciativën për formimin e
20 Partisë Demokratike të Kosovës, dhe unë jam angazhu me bo
21 degën e Partisë Demokratike në Deçan. Dhe aty në zgjedhjet e
22 lira të cilat janë ba, unë jam zgjedhë nënkryetare e degës dhe
23 mandej në kuvendin e parë zgjedhor, i cili është mbajtur në
24 vitin 2000, unë jam ba anëtare e këshillit drejtues të
25 partisë.

1 PY. Faleminderit. Kush ishte kryetari i partisë apo
2 udhëheqësi i partisë në atë kohë?

3 PË. Në kuvendin zgjedhor të vitit 2000, që e kemi mbajtur,
4 pasi janë mbajtur kuvende zgjedhorë në të gjitha degët në të
5 gjitha komunat e Kosovës, delegatët e kuvendit që kanë marrë
6 në kuvend kanë votu, edhe kryetar i Partisë Demokratike është
7 zgjedhë i nderuari dhe shumë i respektuari z. Hashim Thaçi. Me
8 kundërkandidatë, kanë qenë dy kandidatë për kryetar, dhe me
9 vota ka fitu Hashim Thaçi.

10 PY. Faleminderit, znj. Dëshmitare. Tani dëshiroj t'ju tregoj
11 disa postime në Facebook nga llogaria jua në Facebook dhe do
12 të kërkoj komentet tuaja lidhur me këto.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, me lejen
14 tuaj do të kërkoja që të shfaqim në ekran dokumentin me numrin
15 ERN.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
17 ta vazhdoni.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] SPOE00342376 deri në 00342376.
19 Dhe në qoftë se mund të shfaqim në ekran njëkohësisht edhe
20 përkthimin në anglisht me të njëjtin numër ERN, përfundon me
21 ET.

22 DËSHMITARJA: A mundeni me e rritë edhe pak?

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

24 PY. Sigurisht. A jeni në gjendje ta shihni tani qartë?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

1 Dëshmitare, a shikoni, a shihni qartë?

2 DËSHMITARJA: Po, po.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

4 PY. Nga ajo që shoh unë është diçka që ju e keni marrë nga
5 profili i Facebook-ut i Bardhyl Mahmutit dhe e keni postuar në
6 profilin tuaj, a është kështu?

7 PË. Po duket se ashtu është.

8 PY. Faleminderit. Tani dëshiroj të lexoj, do lexoj
9 shkurtimisht përmbajtjen e këtij postimi, dhe do t'ju bëj disa
10 pyetje. Po lexoj përkthimin në anën e majtë. Postimi është i
11 datës 24 janar 2021, dhe thotë:

12 "Përkundër faktit të pakontestueshëm se asnjë luftëtar i
13 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës asnjëherë nuk i është shmangur
14 ballafaqimit me drejtësinë, edhe pse akuzat ishin tërësisht të
15 sajvara dhe të motivuara politikisht, gjyqtari i procedurës
16 paraprake Nicolas Guillou refuzoi kërkesën e Avokatit Ben
17 Emmerson që Kadri Veseli të lirohet nga paraburgimi dhe t'i
18 mundësohet mbrojtja në liri.

19 "Vendim i tillë është bazuar në supozimet e ndikuara nga
20 qarqe politike të Beogradit dhe nuk ka asgjë të përbashkët me
21 drejtësinë. Përkundrazi, ky vendim dëshmon për karakterin
22 politik të të ashtuquajturave Dhoma të Specializuara dhe
23 Prokurori i Specializuar. Turp ju qoftë!"

24 Znj. Dëshmitare, a është qëndrimi juaj që akuzat e
25 ngritura kundër disa anëtarëve, pjesëtarëve të UÇK-së

1 përfshirë edhe Kadri Veseli janë të motivuara politikisht?

2 PË. Janë të motivuara politikisht. Serbia po vazhdon edhe më
3 tutje luftën speciale kundër Kosovës. Dhe sajесat e shërbimit
4 sekret serb po diskutohen këtu.

5 Pyetja të cilën ju ma bëtë për Fitnete Ramosën ma kanë bo
6 policia kur më ka arrestu gjatë luftës në qendrën e policisë
7 në Pejë, dhe është për keqardhje që mu ma bëni pyetje të
8 atillë, për një grup e cila sot nuk është e gjallë dhe nuk
9 jeton. Aman të njëjtën pyetje sikur ma ke bo ti sot, ma kanë
10 bo policia në gjykatën e Pejës kur më kanë arrestu më 1, 2, 3,
11 që më kanë mbajtur të lidhur tri ditë, dhe pa hangër, dhe pa
12 pi, dhe me lloj-lloj torturash brenda ndërtesës së policisë në
13 Pejë.

14 Këto nuk janë qëndrime të miat, por janë qëndrime të
15 Bardhyl Mahmutit të cilat unë i ja ka bo *Share* dhe sot po e
16 vërtetoj që e njëjta gjë është.

17 Me sajеса të shërbimeve të fshehta të Serbisë, dhe me
18 dëshmitarë të rrejshëm, nuk është mirë kjo Gjykatë me ra në
19 ato nivele për keqardhje.

20 Unë jam këtu sot dhe nuk e di --

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Dëshmitare, nuk po ju përkthen kush më. Kështu që -- nuk do e
23 përsëris, por ju paralajmëroj se në këtë Gjykatë --

24 Jo, z. Shala, tani nuk është momenti.

25 Në këtë Gjykatë, nuk është e nevojshme të ngrini zërin,

1 dhe në qoftë se unë ju kërkoj të ndaloni, të mos flisni më,
2 duhet të ndaloni. Sepse u përgjigjët pyetjes dhe nuk ishte e
3 nevojshme të hyni më në hollësi. Këtu jeni për të thënë të
4 vërtetën dhe jeni e detyruar të përgjigjeni. Nuk është nevoja
5 të zemëroheni.

6 Ishte pyetje legjitime që ju bë juve, dhe juve duhet
7 thjesht të përgjigjeni pyetjes.

8 DËSHMITARJA: A mund ta them edhe një fjalë?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
10 nuk mund të thoni asgjë për momentin. Do t'ia jap fjalën
11 Prokurores dhe ajo do t'ju bëjë pyetjen e radhës.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, pyetja ime e
13 radhës është, a është qëndrimi juaj se vendimet e marra nga
14 kjo Gjykatë janë, bazohen, në supozime nën ndikimin e qarqeve
15 politike të Beogradit dhe që s'kanë të bëjnë fare me
16 drejtësinë?

17 PY. Znj. Prokurore, për çdo ditë në televizion i shofim që
18 Beogradi, shërbimi sekret i Serbisë ka ofru sajesa për ta
19 diskreditu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Këto nuk janë
20 qëndrime të mijat, por janë qëndrime të atyre që i shofin
21 përditë nëpërmjet televizionit. Unë nuk e kam pa, edhe pse nuk
22 kam mujtë me i përcjellë, se s'më kanë interesu shumë këto
23 gjyqe që po bohen këtu, që Prokuroria ka bo ndonjë distancim
24 nga ajo dhe me thanë që nuk janë. Pyetja të cilën ju ma botë
25 për Fitneten më koincidoi me pyetjen të cilën ma kanë bo në

1 SUP-in e Pejës.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
3 bëtë të qartë këtë çështje dhe nuk është nevoja të përsëritet.
4 E keni konstatuar.

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Tani do të doja të shfaqim një postim tjetër nga
7 Facebook-u, mund ta heqim këtë. Dhe do jap numrin e ERN-së që
8 të shfaqim tjetrin.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
10 të vazhdoni me këtë, znj. Sekretare.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] ERN-ja është SPOE00342374 deri
12 në 00342375, bëhet fjalë për faqen e parë. Dhe përkthimi
13 përkatës ka të njëjtin numër ERN-je dhe përfundon me ET.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
15 Sekretare, shfaqni dokumentin e kërkuar në ekran, ju lutem.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

17 PY. Znj. Dëshmitare, e shihni në ekran këtë që shfaqet aty?

18 PË. Po.

19 PY. A mund të na thoni çfarë është kjo? Për çfarë bëhet fjalë
20 që e keni postuar, çfarë postimi është?

21 PË. Po mendon këtu që i kam shkru unë? Këtu çka kam shkru, se
22 unë ia kam bo *Share* një postimi të Edi Ramës, a po?

23 PY. E kuptoj këtë --

24 PË. Qartësoma pyetjen, të lutem.

25 PY. Së pari desha të konfirmoj që kjo është diçka që ju e

1 keni postuar në llogarinë tuaj Facebook?

2 PË. Po e kam postu dhe po ta ritheksoj sot, këta që i kam
3 shënu këtu, që nuk është vendi me u diskutu këtu se nuk jam në
4 atë pjesën e Gjykatës për këta, janë vlera e kombit tonë, janë
5 vlera e jetës tonë në liri. Dhe janë krenaria e kombit tonë.
6 Po ta ritheksoj --

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
8 Dëshmitare, nuk do t'ju lejoj të flisni më shumë. Dhe këtu nuk
9 do t'ju përkthehet kjo pjesë.

10 Ju lutem përgjigjuni vetëm pyetjeve. Këtu jeni në
11 cilësinë e dëshmitares, dhe keni detyrimin t'u përgjigjeni
12 pyetjeve që ju parashtohen.

13 Prokurore, mund të vazhdoni.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Në këtë postim keni përmendur disa individë, të gjithë i
16 kemi, i lexojmë këta, të gjithë këta persona janë të akuzuar
17 në këtë Gjykatë, përfshirë edhe Pjetër Shalën, që është i
18 akuzuar në këtë çështje. Dhe ju keni përmendur këtu që këta
19 janë, këta individë janë vlerat e kombit tonë dhe të lirisë
20 tonë.

21 Desha t'ju pyes, tani dua t'ju pyes për çfarë e keni
22 fjalën kur përdorni këtë fjali, vlera e lirisë sonë, vlera e
23 jetës tonë në liri?

24 PË. Çfarë pyetje është kjo? Por këta njerëz e kanë çliru
25 Kosovën, këta njerëz kanë bo luftë të pastër dhe të drejtë

1 çlirimtare. Këta njerëz na kanë mbrojtë neve nga gjenocidi që
2 e ka bo shteti i Serbisë, si mos t'i vlerësomë këta njerëz?
3 Këta janë vlera e kombit tonë, vlera e jetës tonë në liri.
4 Këta janë çlirimtarët tanë. Prandaj jo këtu, por njiqind herë
5 kam me i thanë këto. Sepse janë vlerë dhe këta njerëz janë në
6 këtë Gjykatë, e cila për fatin e keq është bërë qesharake.

7 Kanë ardhë këtu me sajusat të cilat i ka bo shërbimi
8 sekret serb me luftën e tyre speciale --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
10 po përsërisni atë që thatë më parë.

11 Ju kam ndaluar, kështu që nuk -- në këtë moment nuk po ju
12 përkthejnë më. Dhe nuk ju lejojmë që ta quani këtë Gjykatë
13 qesharake. Nuk është e nevojshme që të përdorni këto lloj
14 fjalësh.

15 DËSHMITARJA: [Mikrofoni çaktivizuar]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
17 nuk jua kam dhënë fjalën.

18 DËSHMITARJA: [Mikrofoni çaktivizuar]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
20 nuk jua jap fjalën, kështu që tani nuk po përktheheni.

21 Znj. Prokurore, mund të bëni pyetjen e radhës. Kjo ka
22 marrë përgjigje të mjaftueshme, kjo që bëtë më parë.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] faleminderit.

24 PY. Znj. Dëshmitare, në kohën kur keni pasë ndarë, apo
25 ripostuar këtë gjë, a ishit në dijeni të akuzave të ngritura

1 nga kjo Gjykatë kundër Pjetër Shalës?

2 PË. Unë nuk e kam shiku kurrë aktakuzën kundër Pjetër Shalës
3 sepse nuk më ka interesu një akuzë e cila është e ngritme mbi
4 sajesat e dëshmitarëve të rremë.

5 Hajt, më thuj znj. Prokurore se pse jam unë e ulur këtu?
6 Këtu ku jam ulur, ke mujtë me qenë edhe ti e ulur. A e ke
7 njoftë ti Pjetër Shalën në vitin 1999? A ia ke ditë emrin
8 Pjetër Shalës, a ke qenë mjek i tij? Sigurisht që jo.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
10 Dëshmitare. Tani nuk po ju përkthejmë ato që po thoni.

11 DËSHMITARJA: [Mikrofoni çaktivizuar]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E di
13 që e dëgjuat atë që ju thashë. Këtu pyetjet nuk i bëni ju. Ju
14 lutem, përgjigjuni pyetjeve që ju bëhen.

15 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Kam një pyetje të fundit, znj. Dëshmitare. Pastaj do të
18 kërkoj që të shfaqet prova e fundit, por së pari desha t'ju
19 pyes a jeni në dijeni, njihni akuzat që janë ngritur kundër
20 Salih Mustafës?

21 PË. As që dua t'i lexoj akuzat të ngritura nga sajesat e
22 shërbimit sekret serb. As që du me i lexu.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Atëherë a mund të kërkoj të
24 shfaqim në ekran provën e fundit materiale me numër
25 SPOE00342377 deri në 00342379, faqja 1, dhe përkthimi anglisht

1 përkatës është me të njëjtin numër.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Sekretare, shfaqni në ekran dokumentin e kërkuar, ju lutem.

4 Dhe juve, znj. Dëshmitare, kur t'ju bëhet pyetja, ju

5 lutem, ruani qetësinë gjatë dhënies së përgjigjes tuaj.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

7 PY. Znj. Dëshmitare, e njihni këtë postim?

8 PË. Po.

9 PY. Do lexoj shkurtimisht përmbajtjen:

10 "Jemi të gjithë Cali!

11 "Faktet e dëshmitë e rrejshme mjerane të fabrikuara le të

12 rëndojnë mbi ndërgjegjen e gjithsecilit që i ka dhënë dhe që

13 ka rënë në grackën e regjimit gjenocidal të Serbisë.

14 "Edhe dëshmitë e rrejshme janë të dënueshme. Një ditë

15 besoj do të kthjelllet drejtësia vendore ndërkombëtare e rënë

16 përtokë sot."

17 Tani, znj. Dëshmitare, thatë që ju nuk e keni lexuar këtë

18 akuzën kundër Salih Mustafës, në qoftë se është kështu si mund

19 të deklaroni që akuzat, provat, dëshmitë në këtë çështje janë

20 të pavërteta dhe të fabrikuara?

21 PË. Çdo dëshmi e cila është dhënë për luftëtarët e Ushtrisë

22 Çlirimtare të Kosovës që kanë bo luftë të pastër, të drejtë

23 dhe çlirimtare, është dëshmi e fabrikume. Ndoshta atëherë,

24 ndoshta sot do ta kisha shkruar edhe ma fuqishëm meqenëse jam e

25 ulur këtu mbi një dëshmi të rrejshme që e kuptova sot këtu se

1 unë nuk kam ditë pse kam ardhë këtu në Hagë. Unë nuk e kam
2 ditë, për çka.

3 Nuk e kam ditë si e keni gjetë ju emnin tem me më thirrë
4 këtu. Domethënë, e keni gjetë mbi një dëshmi të rrejshme. Dhe
5 po të kisha pasë mundësi, kisha rregullu edhe pak këto. Këtu
6 që e kam qitë. Se sigurisht ka pasë raste sikur për mu që jam
7 ardhë këtu, si dëshmitare, mbi një dëshmi të rrejshme, mbi
8 sajesa, të shërbimeve sekrete serbe dhe çka me thanë.
9 Sigurisht dhe për këtë ka pasë ndonji rast sikur rasti jem,
10 megjithëse nuk i di.

11 Për këtë po them që është për keqardhje.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që ta
13 dini znj. Dëshmitare, jeni këtu me kërkesë të Mbrojtjes. Po
14 jua kujtoj këtë.

15 Znj. Prokurore, keni fjalën ju.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Më lejoni të konsultohem me
17 kolegët e mi për të parë në qoftë se ka ngelë ndonjë gjë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
19 të përfundojmë tani.

20 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Me këtë mbaruam pyetjet tona.

22 PY. Faleminderit, znj. Dëshmitare.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Mbrojtësi i Viktimave, do bëj planifikimin e punës për

1 nesër, a keni ndonjë pyetje ju për këtë dëshmitare?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Shumë pak pyetje. Ndoshta pesë
3 minuta. Mund ta bëj tani në qoftë se mund ta bëjmë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta
5 shohim. Kaq kohë kishim për sot.

6 Z. LAWS: [Përkthim] E kuptoj.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Shala, do ta jap fjalën kur të mbarojmë me këtë pjesë.

9 Z. Avokat Mbrojtës, a jeni në gjendje të na thoni a do
10 keni nevojë të bëni pyetje më vonë?

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, por përpara që t'i jepni
12 fjalën Pjetër Shalës, do të doja të konsultohem me të
13 paraprakisht.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
15 në rregull. Por do t'i them z. Shala që mund t'i jepet fjala
16 nesër, sepse në kohën që na ka mbetur, nuk e di si mund t'i
17 bëjmë të dyja. Kështu që do t'i them z. Shala që ju do
18 bisedoni me të më vonë këtë mbasdite, dhe që pastaj ai mund
19 të, do të ketë prapë mundësinë që të marrë fjalën nesër.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Avokati juaj, z. Shala, më kërkoi t'ju them që do të bisedojë
23 me juve sot pasdite, dhe në qoftë se keni diçka pastaj që ta
24 bashkëndani me Trupin Gjykses, do ta bëni nesër kur të
25 vazhdojmë me marrjen në pyetje të dëshmitarit.

1 Nuk do të ta jap fjalën tani dhe kjo bazohet në kërkesën
2 e parashtruar nga Avokati juaj vetë.

3 Znj. Dëshmitare, faleminderit për dëshminë tuaj sot. Ju
4 uroj mbrëmje të këndshme, Punonjësja e Gjykatës do t'ju
5 shoqërojë jashtë sallës së gjyqit. Do shihemi përsëri nesër në
6 orën 9.30. Nuk pres që të zgjasë shumë, ndërkohë ju lutem mos
7 bisedoni përmbajtjen e dëshmisë tuaj me askënd jashtë sallës
8 së gjyqit. Faleminderit, mund të largoheni me zonjën që është
9 pranë jush.

10 Tani jo, jo tani. Nuk është momenti i duhur. Për tani
11 kemi përfunduar.

12 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Përpara se të ndërpresim, të përmbyllim seancën për sot,
16 a ka ndonjë gjë që palët dhe Mbrojtësi i Viktimave dëshirojnë
17 të paraqesin?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Asgjë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull. Mbylлим seancën për sot. Shihemi nesër në orën 9.30.

23 --- Seanca mbyllet në orën 16.11

24

25